Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

alter habitus | instituti për studime në shoqëri dhe kulturë

Ku janë paratë për të drejtat e grave?

RAST STUDIMI PËR KOSOVËN

Ku janë paratë për të drejtat e grave?

Rast studimi për Kosovën

Prishtinë, 2013

© Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës dhe Alter Habitus – Instituti për Studime në Shoqëri dhe Kulturë, 2013

Nga Nicole Farnsworth dhe Elmaze Gashi

Përkthyes: Translation Company

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky publikim mund të kopjohet dhe të shpërndahet në tërësi apo pjesërisht, derisa autoret dhe publikuesit e raportit citohen në përdorimin e raportit. Ky publikim është realizuar me mbështetjen e Association for Women in Development (AWID) përmes grantit AWID 2013 Innovation Seed Grant, si dhe duke iu falënderuar mbështetjes nga Kvinna till Kvinna. Qëndrimet në këtë raport janë qëndrime të autoreve dhe nuk paraqesin në asnjë mënyrë qëndrimet apo mendimet e AWID, Kvinna till Kvinna, RrGGK-së apo Alter Habitus.

ISBN 978-9951-8848-2-2

www.womensnetwork.org
www.alterhabitus.org

Printuar nga Night Design në Prishtinë, Kosovë

awid women's rights
Association For Women's Rights in Development

Kvinna till Kvinna

Përmbajtja

Mirënjohje 1

Akronimet 2

Përmbledhje ekzekutive 3

Rekomandimet 7

Hyrje 15
Historia e shkurtër e Kosovës (dhe Shoqërisë Civile) 19

Kapitulli 1. Pse është e rëndësishme të financohen organizatat e grave 24
Pse të financohet barazia gjinore dhe të drejtat e grave? 24
Pse të financohen organizatat për të drejta të grave? 25

Kapitulli 2. Ku janë paratë? 38
Sistemet e pamjaftueshme për të përcjellur shpenzimet 38
Financimi për barazi gjinore dhe për të drejta të grave 40
Financimi për organizatat e grave 45

Kapitulli 3. Trendet e financimit 66
Strategjitë e donatorëve dhe politikat e vendit 66
Përfshirja e Çështjeve Gjinore 67
Nga mbështetja e shoqërisë civile në ndihmë bilaterale? 69
Ndryshimi i kontekstit politik në Kosovë 73
Privatizimi i ndihmës? Grante vs. Kontrata 74
"Ujitja e gjetheve, tharja e rrënjëve" 76

Bibliografia 80

Shtojcat 82
Shtojca 1. Fragment nga AWID 82
Shtojca 2. Donatorët me fonde për Organizatat të Grave 88
Shtojca 3. Metodologjia e hulumtimit 93
Shtojca 4. Organizatat e anketuara 95
Shtojca 5. Lista e Organizatave që morën pjesë në hulumtim 97
Shtojca 6. Lista e Donatorëve që janë konsultuar 100

Mirënjohje

Rrejti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) dhe Alter Habitus Instituti për Studime në Shoqëri dhe Kulturë falënderojnë Association for Women's Rights in Development (AWID) për mbështetjen e tyre në këtë hulumtim, dhe në veçanti Angelika Arutyunova e cila ka kontribuar në mënyrë të vazhdueshme në këtë hulumtim. Ekipi hulumtues vlerëson kontributin e organizatave anëtare të RrGGK-së, donatorëve, dhe institucioneve ndërkombëtare, falënderon për kohën dhe gatishmërinë për të qenë pjesë e këtij hulumtimi. Pa pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e tyre ky hulumtim nuk do të ishte i mundur. Autoret falënderojnë gjithashtu Emine Berishën, Anita Prapashticën, Dafina Beqirin, Itziar Mujika dhe Zana Rudin për asistencën gjatë intervistave dhe futjen e të dhënave. Gjithashtu, kontributi nga RrGGK-ja dhe AH-ja ishte thelbësor dhe ka mundësuar një prezantim të rekomandimeve dhe të gjeturave në formën më të mirë të mundshme.

Akronimet

ABGJ	Agjencioni për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit
AH	Alter Habitus Instituti për Studime në Shoqëri dhe Kulturë
SIDA	Sindroma e fituar e mungesës së imunitetit
PMN	Platforma për menaxhim të ndihmës
AGZH	Asociacioni i Grave në Zhvillim
KEDG	Konventa për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
BE	Bashkimi Evropian
IEDDN	Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut
VMI	Virusi i mungesës së imunitetit
TIK	Teknologjia informative dhe komunikimit
IPA	Instrumenti Ndihmës Para Anëtarësimit
QTSGJ	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
RrGGK	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
LGBT	Lezbike, Gay, biseksual, dhe transgjinor
M&V	Monitorim dhe vlerësim
OZHM	Objektivat Zhvillimore të Mijëvjecarit
OTAV	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
NNZH	Ndihma Ndërkombëtare për Zhvillim
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RAE	Roma, Ashkali, Egjiptian
GSGJ	Grupi për Siguri dhe Gjini
FKBF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
RSKB	Rezoluta e Sigurisë së Kombeve të Bashkuara
DHG	Dhuna ndaj grave
OJQN	Organizata Joqeveritare Ndërkombëtare
OJQL	Organizata Joqeveritare Lokale
OKAZH	Organizata Komiteti i Asistencës për Zhvillim

Përmbledhje ekzekutive

Organizatat për të drejtat e grave luajnë rol të rëndësishëm në përkrahjen dhe krijimin e institucioneve demokratike, avancimin e të drejtave të grave si të drejta të njeriut, ndryshimin e normave gjinore, ngritjen e vetëdijes publike, ofrimin e shërbimeve për grupet të margjinalizuara (veçanërisht kur mungon përkrahja nga shteti), dhe kërkimin e llogaridhënies nga qeveria përmes avokimit. Të gjitha këto aktivitete kërkojnë përkushtim dhe resurse.

"Nuk ka çështje të cilat janë vetëm çështje të grave. Këto janë çështje të të drejtave të njeriut dhe duhet të trajtohen si të tilla." – Donator

Prandaj, në studimin global, tetëvjeçar që është duke u zhvilluar, Asociacioni për të Drejtat e Grave në Zhvillim (tani e tutje do t'i referohemi me akronimin në anglisht AWID) ka shtruar pyetjen: "Ku janë paratë për të drejtat e grave?" Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës në partneritet me Alter Habitus – Institutin për Studime në Shoqëri dhe Kulturë (AH) është përpjekur të kontribuojë në iniciativën më të gjerë hulumtuese të AWID-it përmes një rasti studimor për Kosovën. Ekipi hulumtues ka tentuar të shoh se sa është i përhapur trendi global i financimit në një vend të caktuar (pas konfliktit), siç është Kosova dhe çka do të mund të bëhej ndryshe. Hulumtimi po ashtu ofron informata të rëndësishme për trendët e financimit në Kosovë, të cilat mund të shërbejnë në planifikimin strategjik të donatorëve por edhe të organizatave për të drejtat e grave.

Në mënyrë specifike, hulumtimi ekzaminoi: rëndësinë që ka mbështetja e organizatave të grave në proceset e ndryshimeve shoqërore; ndryshimet historike në trendet e financimit mes viteve 2000 dhe 2013; qëndrueshmëria financiare e organizatave të grave; trendet që ndikojnë në vendimet e donatorëve për financimin (ose mos financimin) e organizatave të grave, dhe mundësitë e bashkëpunimit mes organizatave të grave dhe donatorëve në krijimin e strategjive të përbashkëta për mobilizimin e resurseve dhe mekanizmave të financimit për organizatat e grave. Zhvilluar nga muaji janar deri në shtator 2013. Hulumtimi përfshin 40 intervista me

donatorët të cilët janë në Kosovë, dhe pyetësor me 90 organizata të grave, rishikim të botimeve ekzistuese në këtë fushë, dhe vlefshmërinë e të dhënave.

Të gjeturat kryesore

Pyetësori i zhvilluar me 90 organizata të grave në Kosovë tregon që ka rënie të dukshme të financimit nga viti 2001 dhe 2013, me një rritje të vogël në vitin 2011. Mesatarja e të ardhurave vjetore ka shënuar rënie nga 54,197 Euro në 2005 në 37,032 Euro në 2012. Kishte dallime të mëdha mes organizatave me bazë në Prishtinë dhe atyre në qytetet tjera, ku këto të parat pranojnë shumicën e fondeve derisa këto të fundit kanë hasur në vështirësi për të siguruar mjete të mjaftueshme për çështjet në të cilat ato punojnë, apo për grupet me të cilat ato punojnë; 58% të organizatave të grave kanë deklaruar se nuk kanë pranuar *asnjë* në vitin 2011 për të punuar drejt çështjeve të cilat ato kanë vlerësuar si prioritet.

Më pak se 10% e organizatave të grave kanë siguruar mbështetje nga individë, apo kanë arritur të sigurojnë fonde nga pagesa e anëtarësisë, nga aktivitetet fitim prurëse, dhe kjo tregon se ekziston një varësi nga financimi i organizatave ndërkombëtare dhe ka mungesë të shumë llojshmërisë të resurseve financiare. Mungesa e fondeve ka rezultuar në atë mënyrë që 70% e organizatave janë detyruar të reduktojnë stafin e tyre, të zvogëlojnë numrin e aktiviteteve të planifikuara, dhe / apo të punojnë në mënyrë vullnetare për një periudhë të caktuar kohore. Tutje, 36% e organizatave të grave kanë deklaruar se kanë qenë në rrezik të mbyllin organizatën dhe zyrat, e disa prej tyre i kanë mbyllur ato kohë pas kohe, dhe kjo ka pasur pasoja të rënda për grupet e margjinalizuara, siç janë personat që kanë pësuar nga dhuna.

Nga 40 donatorë që kanë marrë pjesë në hulumtim, vetëm pesë prej tyre kanë financuar organizatat e grave. Disa i vënë fondet në dispozicion përmes aplikimeve të rregullta (p.sh., për grante ose kontrata), për të cilat organizatat e grave shpesh duhet të konkurojnë me organizata ose bizneset e tjera. Donatorët janë të prirë të ofrojnë financim afatshkurtër dhe të bazuar në projekte. Kështu, 76% e organizatave të grave nuk kanë marrë kurrë fonde institucionale.

Me disa përjashtime, donatorët nuk kanë treguar se nuk e shohin të nevojshme të financojnë organizatat e grave, derisa çështjet gjinore janë të përfshira në punën e organizatave tjera (edhe pse pak nga ta kanë pasur njohuri rreth asaj se si bëhet përfshirja e çështjeve gjinore në projekte). Donatorët kishin informacione të pakta rreth ndikimit që organizatat e grave kanë pasur prandaj kanë shprehur dyshimet e tyre rreth kapacitetit të grupeve të grave, dhe kjo ishte një arsye pse ata hezitonin të mbështesnin këto grupe.

Përfundimet

Përfundimet e ekipit hulumtues janë të njëjta me ato në studimin ndërkombëtar të AWID-së "Ku janë paratë për të drejtat e grave", edhe pse duhet kushtuar vëmendje disa shqetësimeve lokale.

- Donatorët janë të prirë të pajtohen se financimi i barazisë gjinore është i rëndësishëm; pyetja është se *si*. Disa donatorë janë të angazhuar në zhvillimin e strategjive të reja në këtë aspekt.

- Përderisa financimi për barazinë gjinore duket se është rritur mes viteve 2008 dhe 2011, kjo nuk është përkthyer gjithmonë në financim të organizatave të grave. Vetëm përafërsisht 39% e gjithë financimit që donatorët kanë "ndarë" për barazi gjinore ose për të drejtat e grave në Kosovë u ka shkuar organizatave të grave. Ekziston një mbështetje substanciale për organizatat e fuqishme që kryesisht janë me seli në Prishtinë.

- Ndryshimi i statusit politik të Kosovës, largimi i donatorëve, shpërndarja gjithnjë e më e madhe e ndihmës bilaterale përmes Qeverisë së Kosovës (krahasuar me shpërndarjen përmes shoqërisë civile), "privatizimi" i asistencës zhvillimore dhe mbështetja afatshkurtër e bazuar vetëm në projekte, të gjitha paraqesin rrezik për qëndrueshmërinë e organizatave për të drejtat e grave. Mbështetja e pamjaftueshme thelbësore nga burime joqeveritare në mënyrë të veçantë e rrezikon aftësinë e organizatave avokuese për t'i mbajtur zyrtarët përgjegjës dhe për të sjell ndryshime të reja shoqërore dhe të politikave drejt avancimit të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave.

- Mbledhja e të dhënave mbetet e zbehtë tek të gjithë akterët. Nëse donatorët janë të dobët në buxhetim të ndjeshëm gjinor (d.m.th, përcjellja se sa para shkojnë për avancimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave), atëherë edhe organizatat e grave janë të dobëta në përcjelljen dhe raportimin e ndikimit afatgjatë të atyre kontributeve financiare. Monitorimi dhe vlerësimi fokusohet në rezultatet afatshkurta, me kërkesë të donatorëve për përkrahjen e tyre një vjeçare. Mirëpo, dihet se ndryshimi i normave gjinore nuk mund të jetë aktivitet afatshkurtër dhe këto praktika marrin kohë dhe matja e ndryshimeve duhet të jetë në një plan më afat gjatë.

Rekomandimet

Ky hulumtim përpiqet të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin në financimet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe për të drejtat e grave në Kosovë. Rekomandimet tona janë për qeverinë, donatorët dhe organizatat e grave.

Përmirësimi i koordinimit mes institucioneve qeveritare, organizatave të grave dhe donatorëve

- Themelimi i një organi për koordinimin e donatorëve nga Ministria e Integrimit Evropian dhe takimi koordinues i donatorëve i organizuar nga kjo Ministri bashkë me Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ) për të diskutuar financimin për barazi gjinore kanë qenë hapa fillestarë pozitiv.[1] Ministria dhe ABGJ duhet të vazhdojnë organizimin e takimeve koordinuese tremujore, përfshirë edhe komponentin e caktimit të strategjive, me qëllim të përmirësimit të koordinimit dhe mbështetjes më strategjike të iniciativave për barazi gjinore, në bazë të Deklaratës së Parisit. Përfaqësueset e organizatave të grave duhet të jenë pjesë e kësaj. ABGJ mund të bashkëpunojë me gratë udhëheqëse nga politika dhe shoqëria civile për të identifikuar fushat kyçe që kanë nevojë për përkrahje para takimeve me donatorë, në mënyrë që në këto takime të mund të bëhen kërkesa specifike për financim të koordinuara me qeverinë dhe shoqërinë civile si pjesë e një strategjie më të gjerë qeveritare.

  "Të gjithë donatorët mund të mobilizohen përreth strategjisë së qeverisë për barazi gjinore. Neve na duhet një platformë më e mirë dhe më aktive për koordinim. Duhet të ketë një takim informativ për donatorët. Qeveria duhet të mobilizojë fonde nga donatorët. Ata po ashtu duhet të ndajnë para të qeverisë." – Donator

- Për përmirësimin e pronësisë vendore dhe qëndrueshmërisë, koordinimi i Grupit për Siguri dhe Çështje Gjinore (GSÇGJ) mund të merret përsipër nga ABGJ në konsultim të ngushtë me

[1] Takim në Qeverinë e Kosovës, 18 prill 2013.

Ministrinë e Integrimit Evropian. Përtej sigurisë, GSÇGJ mund të zgjerohet për tu marrë edhe me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me barazinë gjinore. Përveç takimeve të përgjithshme koordinuese, nëngrupet mund të fokusohen në çështje të caktuara, duke ndjekur praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra nga GSÇGJ-të ekzistuese për dhunë seksuale dhe në familje. Kjo do të konsolidonte numrin organeve koordinuese të donatorëve për një shfrytëzim më efikas të kohës, duke kaluar nga shkëmbimi i informatave në caktimin e strategjive dhe koordinimin më konkret. Shqetësimi i ngritur rreth asaj nëse ABGJ-ja është e gatshme të marr rolin[2] për koordinimin e këtij aktiviteti, donatorët duhet të marrin përgjegjësi të fuqizojnë kapacitetin e ABGJ-së për një koordinim më të mirë me partnerët e asistencës zhvillimore dhe në këtë mënyrë që fillojnë dhe të tregojnë gatishmëri të marrin në pronësi këtë aktivitet sipas Deklaratës së Parisit.

Për organizatat e grave

- Ndikoni në agjendë në vend se të reagoni ndaj saj: organizatat e grave duhet të avokojnë më shumë si te qeveria ashtu edhe te donatorët, duke ofruar dëshmi se pse financimi i organizatave të grave është veprim strategjik. Organizatat kanë mundësi të ndikojnë në strategjitë e donatorëve duke ju përgjigjur kërkesave të donatorëve për konsultime dhe komente, si dhe duke ju qasur donatorëve në mënyrë proaktive me informata për nevojat e tyre. Meqenëse disa donatorë janë në proces të rishikimit të strategjive të tyre afatmesme për Kosovën, ndikoni që zëri juaj të dëgjohet kur është fjala për prioritetet e grave dhe mënyrën më të mirë për të mbështetur organizatat.

- Krijoni raporte pozitive me Ministrinë e Integrimit Evropian, përgjegjëse për mbikëqyrjen e ndihmës

"Fondet janë në dispozicion, por varet nga gratë që ta mbajnë përgjegjëse qeverinë për atë se si ata i koordinojnë ato fonde. Qeverisë i duhet një strategji e mirë e pastaj donatorët do të përgjigjen pozitivisht." – Donator

[2] Çështje e ngritur nga diskutimet e zhvilluara në takimin e prezantimit të rezultateve preliminare, Prishtinë, shtator 2013.

për zhvillim (ODA), dhe avokuese për mbështetjen e vazhdueshme të barazisë gjinore, të drejtave të grave, e në mënyrë specifike, të organizatave të grave.

- Forconi ekspertizën tuaj në një ose dy fusha kryesore, në mënyrë që atë ekspertizë t'ia ofroni qeverisë dhe/ose donatorëve. Kjo mund t'i sjell organizatës suaj resurse shtesë, pasi që ju mund të kontraktoheni si eksperte në ofrimin e shërbimeve të tilla.

"Teorikisht, organizatat e grave duhet të jenë ndër akterët më të rëndësishëm. Në praktikë, ato nuk kanë kapacitete të jenë akterë kyç. Ato duhet ta forcojnë rolin e tyre sa i përket njohurive në mënyrë që të mund të jenë mbikëqyrëse më efektive." – Donator

- Tregoni ndikimin që ju keni në komunitet: organizatat e grave duhet të dokumentojnë më mirë publikisht rezultatet dhe ndikimin e punës së tyre. Ato duhet ti informojnë donatorët dhe të tjerët për rezultatet pozitive dhe efektin e arritur. Siguroni transparencë dhe llogaridhënie më të madhe, edhe duke publikuar raportin vjetor me informata për programet, rezultatet, ndikimin dhe financat tuaja. Nëse ju mungojnë fondet për publikim, këto informata mund t'i postoni në internet, p.sh, përmes faqes (pa pagesë) së organizatës suaj në Facebook.

- Bashkëpunoni më shumë për një qasje kolektive: organizatat mund të bashkëpunojnë për të pasur ndikim më të madh në strategjitë e financimit të donatorëve dhe në mobilizimin e resurseve. Mbledhja e fondeve mund të krijojë konkurencë dhe humbje të ndikimit, duke kontribuar kështu më shumë në ndarje se sa në solidaritet. Organizatat mund të bashkëpunojnë më shumë në identifikimin e nevojave dhe strategjive të përbashkëta.

"Praktika më e mirë ka qenë bashkëpunimi ndërmjet organizatave të grave, që ka ndihmuar në krijimin e sektorit të OJQ-ve. Për shkak të zvogëlimit të konsiderueshëm të donacioneve, OJQ-të e shohin njëra tjetrën më shumë si konkurente se sa si bashkëpunëtore. Duhet të ketë ndryshim në qasje nga asociacionet dhe donatorët kur është fjala për financimin e organizatave të grave." – OSHC

Pastaj mund të mobilizojnë mbështetjen financiare për këto strategji të përbashkëta. Siç komentoi një donator, "Kohërat e mbështetjes së një organizate .... nuk kanë marrë fund, por nuk janë më të mjaftueshme. Pse të kemi një rrjet ose fond? Pse të mos i lëmë organizatat t'i bëjnë punët në mënyrë individuale? Sepse ne arrijmë më shumë rezultate nëse bashkëpunojmë." Bazuar në strategjitë e përbashkëta, organizoni, përmes RrGGK-së, një takim vjetor me të gjithë donatorët e interesuar për t'i paraqitur prioritetet për vitin(et) e ardhshme dhe për të kërkuar përkrahjen e donatorëve për përpjekjet e përbashkëta.

"Vetë shoqëria civile nuk është e organizuar mirë. Ata duhet të takohen njëherë në vit me të gjithë donatorët dhe t'i paraqesin objektivat e tyre dhe çka kanë nevojë vitin e ardhshëm, duke i informuar donatorët. Kjo do tua lehtësonte punën donatorëve dhe ata do të mund të koordinohen. Kur donatorët shohin bashkëpunim, e kanë më lehtë të mbështesin OSHC." – Donator

- Punoni më shumë me meshkuj, përfshirë edhe ata në agjencitë qeveritare dhe OJQ-të e tjera, drejt qëllimeve të përbashkëta, për të siguruar që gratë të jenë pjesë e proceseve më të mëdha në të gjitha çështjet (p.sh., në zhvillimin ekonomik). Aplikimet e përbashkëta tek donatorët e mëdhenj, në bashkëpunim me organizatat e tjera, mund të ndihmojnë në mobilizimin e fondeve derisa transformojnë normat gjinore lidhur me çështje të ndryshme.

"Përfshirja e burrave në këtë proces është edhe një gjë tjetër me rëndësi që duhet ta arrijmë." – OSHC

- Shumëllojshmëria e fondeve: Identifikoni mënyra se si të siguroni fonde nga donatorë të ndryshëm, apo të keni shumëllojshmëri të të ardhurave, duke përfshirë këtu edhe ngritje të fondeve nga komuniteti, duke ofruar shërbime me pagesë, dhe duke kërkuar mbështeje nga sektori privat (bizneset). Bashkëpunoni në përpjekje të përbashkëta me shoqërinë civile për të avokuar për një ambient më të mirë për qytetarët dhe për bizneset të cilat dëshirojnë të kontribuojnë në këtë sektor (p.sh. reduktim të taksave).

- Zgjidhni sektorin e duhur. Disa organizata të grave duhet të konsiderojnë mundësinë të lëvizin në sektorin privat. Organizata të cilat kanë të hyra, dhe kanë qarkullim të parasë dhe gjenerojnë profit, mund t'i takoni sektorin privat, ku qeveria dhe donatorët ofrojnë financim për bizneset që udhëhiqen nga gratë. RrGGK-ja mund të ndihmojë në këtë drejtim për të identifikuar nëse ju i takoni këtij sektori.

"Dua të shoh rekomandime për vetë donatorët, në mënyrë që ata të kuptojnë fushëveprimin, nevojat, kapacitetet, kërkesat: çka thonë OJQ-të se do të ishte më me rëndësi të mbështetet. Nga aty ne mund të fillojmë bashkëpunimin me fituesit e granteve, RrGGK-në ose Fondin Kosovar të Grave për iniciativa të përbashkëta që do të forconin më tej aspektin organizativ të të drejtave të grave në Kosovë dhe punën programore." – Donator

Për donatorët ndërkombëtarë

- Ndani mënjanë fonde për grante shumëvjeçare për organizatat për të drejtat e grave me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve në këtë sektor ku sipas Deklaratës së Parisit që kërkon të "ofrohet mbështetje më afatgjatë". Gjithashtu është shumë e rëndësishme, të investohet në fuqizimin e organizatave dhe lëvizjeve si bashkëpunëtor strategjik në zhvillimin e politikave dhe qeverisjen e mirë.[3]

"Do të ishte fantastike nëse donatorët do të ofronin fonde të mjaftueshme. Çështja për të cilën po flas është ajo që konsistenca dhe investimi në një çështje dhe qëllim të caktuar për një periudhë më të gjatë kohore ofron edhe rezultate më të mira për programet si dhe fuqizon organizatat dhe lëvizjen. Duhet të ekzistojë një agjendë e përbashkët dhe bashkëpunim që të sjellim ndryshime për çështje të caktuara. Tingëllon sikur kur ka fonde të mjaftueshme, ka melodi/muzikë, por kjo duhet të jetë e qëndrueshme, konsistente përgjatë një kohë dhe të ketë bashkëpunim të mirë me përfituesit." - Donator

- Zhvilloni indikator specifik që u përgjigjen matjes së përfshirjes gjinore dhe të përcjellë shpenzimet përgjatë kohës. Përfshirja gjinore duhet të përmbajë edhe ndarjet e buxhetit adekuat për

[3] Komisioni Evropian (2012) rekomandon këtë.

çështje gjinore. Instaloni sisteme financiare që kanë tregues për përcjelljen e shpenzimeve nga perspektiva gjinore

- Rriteni transparencën për shpenzimet duke publikuar raporte reale vjetore dhe duke i vënë në dispozicion në internet, të cilat përfshijnë të dhëna për shpenzimet të ndara sipas gjinive. Këto ndihmojnë në arsyetimin e shpenzimeve para qeverive, tatimpaguesve dhe kontribuuesve të tjerë financiar. Ato po ashtu ndihmojnë në përcjelljen e shpenzimeve përgjatë kohës.

- Drejtë një qasjeje bazuar në nevoja, diskutoni programet e reja dhe/ose planet strategjike përmes emailit dhe grupeve të fokusuara me përfaqësuesit e organizatave të udhëhequra nga gratë në mënyrë që të mblidhen informata kthyese për projektplanet/strategjitë nga perspektiva gjinore. Diskutoni fushat ku organizatat e grave mund të jenë partnerë efektiv në zbatimin e strategjive dhe ndani fondet për të mbështetur përfshirjen e tyre si partnerë.

"Ne duhet të flasim me organizatat e grave për të ditur nevojat e vërteta të komunitetit." - Donator

- Siguroni që përfshirja gjinore ose temat transversale të merren seriozisht, përfshirë edhe përfshirjen e ekspertëve gjinorë vendorë në vlerësimin se sa janë përfshirë në mënyrë të mjaftueshme gjinitë në propozimet (planifikimet) dhe projektet (gjatë vlerësimeve).

- Kontraktoni organizatat për të drejtat e grave si eksperte për të dhënë kontribut në strategjinë dhe programet tuaja nga perspektiva gjinore. Organizatat e kualifikuara të grave mund tu japin informacione dhe ide jetike për përmirësimin e përfshirjes gjinore, duke përfshirë edhe në kuadër të punës suaj drejt zhvillimit ekonomik, qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit. Gratë nuk janë qenie që flasin vetëm për "çështjet gjinore"; ato mund dhe duhet të japin mendime të rëndësishme nga perspektiva gjinore për *të gjitha* çështjet (p.sh., për zhvillimin ekonomik, luftën kundër korrupsionit, avancimin e sundimit të ligjit, dhe qeverisjen e mirë).

- Duke marrë parasysh madhësinë e Instrumentit të Ndihmës Para Anëtarësimit (IPA) të Bashkimit Evropian (BE), Instrumentit Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut (EDIHR) dhe instrumenteve të tjera, BE duhet të vazhdojë të dërgojë strategjitë dhe të kërkojë kontribut (komente) përmes emailit nga organizatat e grave, si dhe gjatë diskutimeve të prioriteteve të financimit. Përfshini organizatat për të drejtat e grave si eksperte në vlerësimin e të gjitha projekteve të IPA-s nga perspektiva gjinore dhe kompensoni ato drejt për ekspertizën e tyre. Bëjeni të obligueshme që Ministria e Integrimit Evropian të përfshijë organizatat e grave dhe përfaqësuesit e tjerë të shoqërisë civile në konsultime lidhur me përdorimin e fondeve të IPA-s, sipas Deklaratës së Parisit.

- Për të arritur deri te grupet në bazë pa dokumentacion, donatorët duhet të ndajnë fonde në kuadër të granteve më të mëdha për organizata më të mëdha për tu ndarë nën-grante organizatave të grave. Ju po ashtu mund të shfrytëzoni fondet lokale, si Fondi Kosovar i Grave i cili mund të sigurojë nën-grante për organizatat e grave, duke zhvilluar kështu kapacitetet e tyre për tu bërë të fuqishme dhe për të aplikuar për fonde të tjera.

"Si donator na intereson të shohim ide të cilat do të ndihmonin në zvogëlimin e punës tonë, në mënyrë specifike në Monitorim dhe Vlerësim, duke trajnuar OSHC të grave të bëjnë këtë." - Donator

- Përfshini kritere afirmative që inkurajojnë organizatat e udhëhequra nga gratë të aplikojnë në thirrjet për paraqitjen e aplikacioneve, ofertave ose propozimeve. Disa organizata të grave kanë ekspertizë, veçanërisht lidhur me përfshirjen gjinore, buxhetin për çështje gjinore dhe avokimin.

Për qeverinë

- Bashkëpunimi me shoqërinë civile është i rëndësishëm për demokracinë, e veçanërisht organizatat e grave mund të sjellin informata të rëndësishme në tryezë të cilat do të informonin politik-bërjen dhe do të lehtësonin zbatimin e legjislacionit

ekzistues. Organizatat e grave mund të kontraktohen për ekspertizën e tyre dhe në këtë mënyrë informojnë politikë bërjen nga perspektiva gjinore.

- Ministria e Integrimit Evropian dhe ABGJ duhet të marrin rolin udhëheqës në organizimin e takimeve tremujore për koordinimin e donatorëve, si dhe takimeve për tema specifike për të diskutuar bashkëpunimin në nivel më strategjik, sipas Deklaratës së Parisit. Organizatat për të drejtat e grave duhet të ftohen në të gjitha këto diskutime.

- Në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi Gjinore si dhe planeve të tjera, ndani resurse për përfshirjen e organizatave të grave si konsulente, ofruese të shërbimeve, eksperte dhe vlerësuese, sipas nevojës.

- Legjislacion që do të mundësonte lehtësime në taksa për individë apo biznese të cilat japin mbështetje financiare për organizatat jo qeveritare dhe jo fitim prurëse.

Hyrje

Organizatat për të drejtat e grave dhe lëvizjet e grave kanë kontribuar në krijimin e kushteve dhe në çdo hap kanë ndihmuar në avancimin e të drejtave të grave duke i vendos këto të drejta në nivel të të drejtave të njeriut.[4] Përmes hulumtimit, aktivizmit, avokimit, dhe ngritjes së vetëdijes, ato kanë zhvilluar politika për barazi gjinore dhe kanë ndryshuar diskursin publik.[5] Megjithatë, përkundër të gjitha arritjeve dhe në mes të një situate kur aktivistet e të drejtave të grave janë duke u sulmuar verbalisht,[6] fondet apo mbështetja financiare për organizatat e të drejtave ka shënuar rënie.

Ku janë paratë për të drejtat e grave? Organizatat e të drejtave të grave konsiderojnë këtë pyetje si qenësore dhe shumë të rëndësishme derisa punojnë për të siguruar fondet. Duke marrë parasysh përkushtimin për avancimin e të drejtave të grave, në nivel global, Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit (OZHM), dhe Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSCR) 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, pyetja që u shtrua më lartë duhet të jetë e rëndësishme edhe për organizatat tjera, institucionet, dhe qeveritë që punojnë me përkushtim në përmbushjen e detyrave. Prandaj, ky hulumtim vjen në një kohë shumë të rëndësishme. Me që viti 2015 po afrohet, dhe rezultatet e këtij hulumtimi mund të shërbejnë si udhëzues për ide të reja në kontekstin e 20 vjetorit të konferencës botërore të grave në Beijing si dhe krijimin e një kornize vepruese post MDG.

Në raportin e katërt FundHer, në vitin 2011, AWID ka iniciuar hulumtimin që synon ti përgjigjet pyetjes, duke mbledhur dijen dhe njohurit nga tetë vjet hulumtimi për këtë çështje. Hulumtimi kishte

[4] Ky paragraf është nxjerr nga Arutyunova, Angelika dhe Cindy Clark të Asociacionit për të Drejtat e Grave në Zhvillim (AWID), *Ujitja e gjetheve, Tharja e Rrënjëve: Status i Financimit të Organizatave për të Drejtat e Grave dhe Barazia Gjinore,* Toronto: AWID, 2013.

[5] Shiko Kapitullin 1.

[6] Në Kosovë në vitin 2012 – 2013, aktivistet e të drejtave të grave janë ballafaquar me kërcënime dhe me gjuhën e urrejtjes dhe të dhunshme, në mënyrë të veçantë nga grupet ekstremiste religjioze 2012-2013.

për qëllim të "mobilizojë më shumë resurse për organizatat e të drejtave të grave duke prodhuar dije dhe analiza të situatës financiare dhe të mënyrës së financimit të organizatave të grave; dhe për të promovuar një strategji gjithëpërfshirëse për mobilizimin e resurseve nga perspektiva e lëvizjes feministe."[7] Gjithashtu synon të informojë të dyja palët, donatorët dhe organizatat e të drejtave të grave për "realitetin në teren" dhe "nevojën urgjente për të rishikuar prioritet e financimit si dhe rrjedhën e financimit duke synuar që më shumë financim duhet për grupet që punojnë për të drejtat e grave." Në raportin e AWID theksohet që kjo analizë e mënyrës se si financohen organizatat e grave është "çështje e rëndësishme politike e luftës për të avancuar të drejtat njerëzore të grave, me që kontrolli dhe shpërndarja e resurseve është poashtu politike."[8]

"Vlerësimi për financimin e organizatave të grave është çështje me rëndësi politike, rrjedhimisht ndihmon në avancimin e të drejtave njerëzore të grave, për shkak se ndarja e resurseve është poashtu politike." - AWID

Në mënyrë specifike, hulumtimi kishte për qëllim të gjejë përgjigje në këto pyetje:

- Pse është e rëndësishme të mbështetën organizatat e grave krahas ndryshimeve në shoqëri?
- Cilat janë ndryshimet historike në trendet e financimit nga ana e donatorëve dhe cila është gjendja financiare e organizatave të grave?
- Sa janë financiarisht të qëndrueshme organizatat e grave?
- Cilat janë trendet e jashtme dhe të brendshme që ndikojnë në vendimin e donatorëve në mbështetjen e organizatave të grave apo lëvizjen e grave?
- Çfarë mundësi ekzistojnë për bashkëpunimin në mes të organizatave të grave dhe donatorëve për të krijuar një strategji mobilizuese për krijimin e resurseve kolektive dhe mekanizmave për financim të organizatave të grave?

[7] AWID, 2013, faqe 14.
[8] AWID, 2013, faqe 31. Gjithashtu shiko shtojcën 1.

Studimi në nivel global i AWID përfshinte intervista me donatorët dhe pyetësor online me më shumë se 1,000 organizata të grave në gjithë botën, pyetësor ky i zhvilluar në pesë gjuhë. AWID publikoj të gjeturat preliminare në Forumin e AWID në 2012 në Stamboll, tek një audiencë e gjerë me shumë organizata dhe donatorë. Gjatë diskutimit, një përfaqësuese nga RrGGK, që është edhe anëtare e AWID, shprehu shqetësimin se pyetësori mund të ketë pasur edhe mangësi në mënyrën se si është realizuar.

Kutia 1. Definicionet

Shoqëria civile i referohet në mënyrë të gjerë gjithë akterëve jashtë sektorit publik (shtetëror) dhe sektorit privat që synon të përfaqësoj interesat e qytetarëve. Mund të përfshijë organizatat jo qeveritare (OJQ-të), grupet të cilat nuk janë të regjistruara dhe funksionojnë në nivel lokal, individë, grupet religjioze, media, dhe në raste të caktuara edhe partitë politike të cilat nuk janë në pushtet. Organizatat e shoqërisë civile përfshijnë këto grupe, dhe jo patjetër vetëm organizatat jo qeveritare të regjistruara.

Organizatat e grave në këtë raport janë definuar si organizata të cilat udhëhiqen nga gratë të cilat *mund ose jo* të ndërmarrin ndonjë veprim për avancimin e të drejtave të grave apo edhe drejt barazisë gjinore. Ato dallojnë nga **organizatat për të drejtat e grave,** të cilat fokusohen në mënyrë specifike të fuqizojnë të drejtat e grave dhe të transformojnë praktikat dhe normat gjinore.

Lëvizjet për të drejtat e grave përfshijnë anëtare të cilat janë mbledhur ne një aksion të përbashkët dhe të cilat kanë një qëllim të përbashkët: të drejtat e grave.[9]

Donatorët: i referohet një grupi të organizatave jo qeveritare, qeveritare, jo profitabile, profitabile, biznese apo organe të cilat kanë dhënë fonde në Kosovë (p.sh., "donacion").

RrGGK, organizatë me 13 vjet përvojë dhe me 103 organizata anëtare në Kosovë, përfaqësueset e Rrjetit ishin në dijeni se jo të

[9] Adaptuar nga Batliwala, S. *Duke Ndryshuar Botën: Konceptet dhe Praktikat e Lëvizjes së Grave*, AWID, 2008.

gjitha anëtaret kanë qasje në internet dhe mund ti përgjigjeshin pyetësorit të AWID. Për më shumë pyetësori ishte në gjuhën angleze dhe jo në gjuhën shqipe dhe serbokroate. Përfaqësueset e Rrjetit kishin sugjeruar se grupet nga vendet rurale nuk kanë pasur mundësi të jenë pjesë e këtij hulumtimi global. Grupet që punojnë në nivel lokal njësojë hasin në sfida për financim sikurse edhe sfida për të marr pjesë në hulumtimin e AWID, e këto sfida janë: mungesa e qasjes në internet dhe mungesa e njohurisë së gjuhës angleze. Prandaj edhe të gjeturat e hulumtimit nga AWID, mund të mos adresojnë çështjet të cilat i preokupojnë këto grupe.

Duke qenë të vetëdijshme për këto zbrastësi, hulumtuesit e AWID nuk kishin resurset e mjaftueshme dhe nuk kishin qasje tek këto grupe për të zhvilluar më tutje hulumtimin e tyre. Prandaj, RrGGK propozoi që me një hulumtim tjetër në nivel të Kosovës, mund t'i kontribuojë të gjeturave të hulumtimit të AWID duke zhvilluar një studim rasti për Kosovën.

Në fillim të vitit 2013, RrGGK dhe organizata anëtare AH pranuan një grant që kishte për qëllim të zhvillonte hulumtimin në fjalë në nivel të Kosovës, dhe kjo do të bëhej në bashkëpunim të afërt me ekipin e AWID. Metodologjia e hulumtimit që është zhvilluar në mes të janarit dhe shtatorit 2013 ishte:

- Pyetësor me 90 organizata të grave, anëtare të RrGGK-së në gjithë Kosovën,[10] duke përdorur pyetësorin e AWID me ndryshme të vogla për përshtatje në kontekstin e Kosovës;
- Intervista dhe shkëmbim me email me 40 donatorë;[11]

[10] Ekipi hulumtues ka synuar të intervistoj të gjitha organizatat e grave të cilat funksionojnë në Kosovë, në kohën e realizimit të hulumtimit, janar 2013 (103), dhe 87% janë përgjigjur. Grupi i cili nuk është përfaqësuar në tërësi janë organizatat e grave serbe në Mitrovicën Veriore (pesë) për shkak të situatës politike, duke mos pasur mundësi për hulumtueset të udhëtojnë deri tek ato organizata. Për statistikat e reprezentimit të grupeve të ndryshme etnike, shikoni Shtojcën 4, dhe për metodologjinë shikoni Shtojcën 3.

[11] Hulumtimi fokusohet kryesisht në donatorët ndërkombëtarë si burim primar i fondeve për organizatat e grave. Fondet qeveritare për organizatat e grave nuk ishin pjesë e këtij studimi, edhe pse RrGGK-ja ka kontaktuar disa ministri të cilat kanë

- Hulumtim online dhe rishikim të literaturës ekzistuese sa i përket fondeve dhe trendeve të donatorëve, përfshirë këtu edhe Platformën për Menaxhim të Ndihmës Ndërkombëtare (AMP), website të donatorëve, strategjitë e donatorëve; dhe
- Konsultim me pjesëmarrësit në hulumtim për të diskutuar gjetjet preliminare, përfshirjen e rekomandimeve të tyre dhe verifikimin e të dhënave.

Ky raport në mënyrë ambicioze tenton të përfshijë analizën për periudhën 15 vjeçare (2000-2014) sa i përket financimit për barazi gjinore dhe të drejtat e grave në Kosovë. Kjo periudhë kohore mundëson të studiojmë se ndryshimet dhe mënyrat se si janë bërë këto financime që nga periudha e luftës, pasluftës dhe zhvillimit shoqëror.

Të gjeturat nga Kosova përmbajnë përvojat dhe mësimet nga vendet e tjera të cilat kanë kaluar nëpër të njëjtën situatë si Kosova, duke pranuar kështu ndihma emergjente, dhe duke u angazhuar në shtet ndërtim. Të gjeturat e këtij hulumtimi do të ju shërbejnë OJQ-ve dhe donatorëve në Kosovë, në mënyrë të veçantë për të reflektuar mënyrën se si në të kaluarën kanë ndërtuar strategjitë e tyre dhe si do të duhej të ndërtojnë ato strategji tani. Donatorët në Kosovë kanë investuar miliona Euro dhe sigurisht shumica prej tyre dëshirojnë të dijnë se sa nga investimet e tyre u janë dedikuar të drejtave të grave apo sa kanë kontribuar në barazi gjinore.

Historia e shkurtër e Kosovës (dhe Shoqërisë Civile)

Dikur provincë autonome në ish Jugosllavi, në vitin 1989 Serbia revokon autonominë e Kosovës. Shumë shpejt pas kësaj, shumica e shqiptarëve të Kosovës përjashtohen nga puna dhe ishin jashtë institucioneve të kontrolluara nga Serbia. Gjatë vitit 1990, shqiptarëve të Kosovës u është mohuar e drejta për shëndetësi, arsimim dhe punësim. Për një dekadë pasoi rezistenca civile jo violente. Gjatë kësaj kohe u themeluan një numër i organizatave joqeveritare të shoqërisë civile, duke synuar kështu të përmbushin dhe zëvendësojnë shërbimet

---

mbështet OJQ-të. Agjencia për Barazi Gjinore nuk i është përgjigjur ftesës për intervistë.

të cilat ishin të udhëhequra nga pushteti. Me mungesë të punësimit, shumica e popullatës së Kosovës, në shumicë shqiptarët (përafërsisht 82%)[12] u mobilizuan të mbushnin këtë zbraztësi. Përfshirja e madhe e qytetarëve në rezistencën paqësore civile kundrejt institucioneve represive Serbe ka sjell thënien e Kosovarëve se e gjithë Kosova ishte shndërruar në një "shoqëri të madhe civile."

Gratë mbajtën gjallë sistemin arsimor të Kosovës duke ligjëruar kështu në shkolla të organizuara në hapësira private, duke ofruar shërbime shëndetësore dhe duke monitoruar shkeljet e të drejtave të njeriut, dhe të gjitha këto aktivitete u zhvilluan me organizata të cilat u themeluan gjatë viteve të 90-ta. Kah fundi i 90-ve gratë dhe aktivistët tjerë themeluan organizata të cilat kishin për qëllim avancimin e të drejtat e grave (p.sh. arsimimi). Organizatat e të drejtave të grave kanë ofruar mundësi të ndryshme në atë kohë, duke filluar me arsimim, shëndetësi, këshillime, ndihmë humanitare, dhe shërbime ligjore për gratë. Disa prej tyre u fokusuan në zhdukjen e analfabetizmit në viset rurale, duke u dhënë mundësi vajzave të reja të kenë qasje në arsimim.

Në vitin 1995, organizatat e të drejtave të grave të cilat punonin në viset rurale themeluan Rrjetin e Grave në viset Rurale. Kjo ishte një ndihmë e madhe për aktivitetet e të drejtave të grave, në një periudhë të vështire të represionit nga shteti, mirëpo ndihmoi edhe në ngritjen e fondeve. Në vitin 1998 ishin afërsisht 12 organizata të të drejtave të grave qe u themeluan në Kosovë. Këto organizata ishin aktive në organizimin e demonstratave masive kundër pushtetit Serb, si p.sh. Marshi me Bukë në Dorë demonstratë kjo që tërhoqi vëmendjen e komunitetit ndërkombëtar për shkeljet e rënda që ndodhnin në atë kohë në Kosovë.[13]

[12] Agjencia i Statistikave të Kosovës (ASK), *Popullësia e Kosovës* , Prishtina: SOK, 2003. Kjo është në bazë të të dhënave të regjistrimit të popullatës në vitin 1981, ku shqiptarët e Kosovës e kanë bojkotuar këtë regjistrim.

[13] Shikoni Qendra për Studime Gjinore (QTSGJ), *Historia është Tregimi i saj, Gjithashtu*, Prishtina: KGSC, 2008.

Gjatë bombardimeve të NATO-së në Kosovë, më shumë se një milion Kosovarë, kryesisht shqiptar u detyruan ta lëshonin vendin e tyre.[14] Shumë të tjerë nga fshatrat ishin zhvendosur nga shtëpitë e tyre gjatë masakrave. Gjatë luftës, diku rreth 10,000 civil ishin vrarë.[15] Organizatat e grave ndihmuan me strehim, këshillim, shërbime shëndetësore, edhe pse një pjesë e madhe e aktivisteve ishin edhe vetë refugjate në atë kohë. Duke bërë këtë përmbledhje, dhe duke parë një lloj neglizhence në atë se sa vlerësohet puna e organizatave të grave në Kosovë para dhe gjatë luftës, është më se e rëndësishme të pranohet publikisht se përvoja, ekspertiza dhe përkushtimi i tyre ishte edhe para se të kishte prezencë dhe ndihmë ndërkombëtare ne Kosovë.

"Përshtypja ime është që pas luftës ka pasur shumë iniciativa të cilat kanë mbështetur fillimin e OJQ-ve të grave. Mirëpo, këto ishin në të shumtën e rasteve përpjekje të drejtuara nga dontorët e jo nga vendoret. Prandaj vjen edhe pyetja, sa para kanë shkuar dhe ku?" – Donator

Shumë shpejt pas kësaj, derisa qytetarët nxitonin të ktheheshin në shtëpitë e tyre, në Kosovë kishte një valë të madhe të ndihmës humanitare. Natyrisht që ky fluks i madh fondesh ka ndikuar edhe në numrin e organizatave në Kosovë. Një numër i madh i tyre janë themeluar si përgjigje ndaj fondeve ndërkombëtare që ishte në Kosovë, duke u zhvilluar kështu në, siç e quajtën disa "kërpudha".[16] Qeveria Amerikane në atë kohë financoi Iniciativën Kosovare të Grave, e modeluar sipas Iniciativës së Grave në Ruanda dhe Bosnja, dhe kjo kontribuoj në regjistrimin e një numri të madh të organizatave të grave.[17] Këto organizata padyshim që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e ndihmave, ofrimin e shërbimeve psiko-sociale sidomos pas përvojave traumatike që ka pasur popullata e Kosovës, dhe ofrimin e shërbimeve në mungesë të shërbimeve nga shteti.

---

[14] Komiteti për Refugjatë dhe Imigrantë në SHBA, "World Refugee Survey 2000: Yugoslavia."
[15] American Bar Association Central dhe Eastern European Law Initiative dhe American Association for the Advancement of Science, "Vrasjet politike në Kosova/Kosovo," mars – qershor 1999, në: http://shr.aaas.org/kosovo/pk/p1_2.html.
[16] QKSGJ, 2008.
[17] QKSGJ, 2008.

Para luftës, gratë shqiptare ishin ato që udhëhiqnin shumicën e organizatave të grave. Ishte vetëm një organizatë që duket të ketë ekzistuar para luftës, me qëllim të ofrimit të ndihmës humanitare për Serbët e zhvendosur nga lufta në vendet tjera të ish Jugosllavisë. Pas luftës, me ndikimin e organizatave ndërkombëtare (posaçërisht ato të cilat shtynin përpara projektet për dialog ndëretnik), dhe me gatishmërinë që të mbështesin gratë nga komuniteti, si dhe me përkrahje dhe inkurajim nga organizatat ekzistuese të grave u themeluan një numër i madh i organizatave Serbe, Boshnjake, Turke, Ashakali dhe Egjiptiane.

Deri në vitin 2005, Kosova kishte rreth 613 organizata të regjistruara të cilat udhëhiqeshin nga gratë (nga 2,593 OJQ të regjistruara). Natyrisht jo të gjitha ishin të fokusuara në të drejtat e grave apo barazi gjinore, dhe jo të gjitha ishin aktive; 224 nga to kemi arritur të i kontaktojmë në atë kohë.[18] Është vështirë të kemi numrin e saktë të organizatave ekzistuese të grave në vitin 2013 sepse zyra për ndërlidhje dhe regjistrim të OJQ-ve nuk mban të dhëna të tilla.[19] Mirëpo, po sugjerojmë që indikator më i mirë për organizatat aktive të grave është anëtarësia e Rrjetit të Grupeve të Grave. Nga gushti i vitit 2013, RrGGK-ja ka 103 anëtare, duke përfshirë gati se të gjitha organizatat aktive të grave në Kosovë. Vetëm disa organizata të cilat janë në veri të Mitrovicës nuk i janë bashkuar RrGGK-së për shkak të dyndjeve politike që mund të ballafaqohen me komunitetin me të cilin punojnë. Anëtarësia e RrGGK-së dhe përvoja tregon se një pjesë e organizatave të grave të themeluara në "Fazën Emergjente" janë mbyllur.[20] Me një popullatë prej 1.8 milion banorëve,[21] Kosova nuk ka nevojë për 613 organizata të grave, edhe pse kanë arritur qëllimin e tyre dhe kanë shërbyer për kohën kur kanë funksionuar.

Pas fazës emergjente të pas lutës, asistenca ndërkombëtare ndërroi kahje nga asistenca humanitare në atë të shtet ndërtimit. Nga shpallja

[18] Kjo ishte pjesë e hulumtimit të zhvilluar nga QKSGJ.
[19] Zyra e Regjistrimit të OJQ-ve ishte 6,883 OJQ të regjistruara në fund të vitit 2012.
[20] QKSGJ (2008) hulumtimi në vitin 2005 ka treguar se një pjesë e organizatave të grave të themeluara pas luftës nuk ishin më funksionale.
[21] Agjencia e Statistikave të Kosovës, website: http://esk.rks-gov.net/, qasur më 20 gusht 2013.

e pavarësisë në vitin 2008, Kosova është pavarësuar nga Kombet e Bashkuara, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), dhe misioni i BE, misione këto të cilat kanë pasur (dhe ende kanë) mandat ligjor për të udhëhequr Kosovës. Këto ndryshime politike natyrisht që kanë ndikuar edhe në financimin e SHC (për më shumë në kapitullin 3).

Konteksti social, ekonomik dhe politik i Kosovës ka ndikuar dukshëm në rritjen (dhe zvogëlimin) e organizatave të grave. Shumë shpesh puna e organizatave të grave ka qenë reflektim i një konteksti më të gjerë në të cilën ato funksionojnë. Prandaj edhe njohuritë dhe dija për kontekstin në të cilën kanë funksionuar këto organizata është shumë i rëndësishëm, dhe kjo do të diskutohet në kapitujt në vijim.

Kapitulli 1. Pse është e rëndësishme të financohen organizatat e grave

Para se të japim përgjigje për pyetjen kryesore "ku janë paratë?", ky kapitull qartëson rëndësinë e alokimit të fondeve për barazi gjinore, të drejtat e grave, dhe organizata të grave.

Pse të financohet barazia gjinore dhe të drejtat e grave?

Në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara, hyrjen e parashikuar të Kosovës në BE, dhe ligjet e aplikueshme të Kosovës, qeveria e Kosovës duhet të punojë dhe sigurojë arritjen e barazisë gjinore.

Sipas një donatori të intervistuar, alokimi i fondeve për barazi gjinore dhe të drejtave të grave është "thelbësore":

> Kosova është në tranzicion, fazë kjo e pas-luftës. Gjatë luftës dhe menjëherë pas luftës, ka pasur investime të shumta në infrastrukturë, rindërtim, demokratizim, sundim të ligjit, dhe plot të tjera me terminologji "magjepsëse". E gjithë kjo respektohet dhe është në rregull por, problemi qëndron në atë se të gjitha këto ose nuk kanë pas të bëjnë me barazinë gjinore, ose edhe kur kanë provuar të kenë qasjen e barabartë dhe perspektivën gjinore, nuk është bërë si e tillë. Në kohën afatgjatë çështjet gjinore, dhe të drejtat njerëzore lihen anash dhe bëhen problem dytësor. Megjithatë, investimi drejt barazisë gjinore dhe të drejtave të grave është i rëndësishëm për parandalimin e një lufte të ardhshme.

Fuqizimi i të drejtave të barabarta apo barazia gjinore dhe në mënyrë specifike të drejtave të grave është i rëndësishëm për krijimin e një shoqërie demokratike që garanton të drejta të grave si të drejtat e njeriut. Ky nuk duhet të jetë rishqyrtim, por pjesë e gjithë procesit të pas luftës, paqes, dhe procesit të ndërtimit shtetit.

Dyzet donatorët e intervistuar gjatë këtij hulumtimi ranë dakord pothuajse njëzëri që fuqizimi i barazisë gjinore dhe të drejtave të grave është "shumë i rëndësishëm" për zhvillimin social, politik dhe ekonomik të Kosovës. "Të drejtat e grave janë të drejta njerëzore, kështu që qeveria ka për detyre t'i përmbush dhe të raportojë në këtë arritje," tha njëri nga donatorët. "Barazia gjinore shkon përkrahë me ndryshimet në shoqëri, dhe proceset tjera të ndryshimit të shoqërisë" dhe është e rëndësishme për demokracinë "sepse gratë përbëjnë 50% të popullatës," komentuan disa tjerë.

Donatorët e konsiderojnë të rëndësishëm procesin e fuqizimit të drejtave të grave për qeverisje të mirë, transparencë, drejtësi, paqe, pajtim, stabilitet, zhvillim ekonomik, sigurimin e mundësive të barabarta, dhe në përgjithësi për zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës. Shumica e misioneve të donatorëve përfshijnë barazinë gjinore. Megjithatë, pyetja me të cilën shumica e donatorëve ndeshen është: me anë të çfarë strategjie ata mund të mbështesin barazinë gjinore? Ky raport argumenton që mbështetja e organizatave për të drejtat e grave është një strategji kyçe.[22]

Pse të financohen organizatat për të drejta të grave?

Ky hulumtim nis me supozimin që sektori privat, publik, dhe ai i shoqërisë civile kanë nevojë për mbështetje afatgjate. Disa donatorë nisen nga supozimi se investimet në sektorin privat[23] ose në sektorin publik japin rezultate më të mira se sa mbështetja e shoqërisë civile. Një aktivist i të drejtave të grave vuri në pah që:

> Kohët e fundit shumë nga donatorët po fokusojnë mbështetjen e tyre në mekanizmat qeverisës; ata mendojnë se këto mekanizma janë të mjaftueshëm për të arritur barazinë gjinore. Ky është një trajtim jo i duhur për këtë çështje. Edhe pse kemi mekanizma, ato nuk funksionojnë siç duhet. ... Në një shtet ku ende nuk kemi barazi gjinore. OJQ-të e grave punojnë për të arritur atë barazi.

[22] AWID (2013) gjithashtu thekson se kjo është strategjia kyçe.
[23] Financimi i sektorit privat nuk garanton se do të i shërbej të mirës së përgjithshme publike, sepse nuk e ka përgjegjësi. Për më shumë shikoni AWID, 2013.

Eksperienca, si ndërkombëtarisht ashtu dhe RrGGK (p.sh. me ligjin për mbrojtjen viktimave të dhunës në familje), sugjerojnë që bashkëpunimi në mes të sektorëve është kyç për ndryshime shoqërore. Ashtu si financimi vetëm për shoqërinë civile nuk mund të siguroj institucionalizimin e politikave drejt barazisë gjinore, ashtu edhe financimi vetëm për qeverinë nuk mund të sigurojë implementimin e tyre. Mbikëqyrja nga shoqëria civile, duke përfshirë dhe atë të organizatave për të drejtat e grave, mund të ndihmojë në procesin e llogaridhënies nga qeveria dhe kështu ta mbajë përgjegjëse atë.

"Organizatat e grave janë më se të rëndësishme. Roli i tyre ka qenë i padiskutueshëm, dhe për të gjitha ndryshimet që i kemi parë pas luftës meritat u takojnë atyre." – Donator

Dëshmitë anembanë botës tregojnë se organizatat e grave luajnë një rol vendimtar në ndikimin për ndryshime shoqërore.[24] Fondi Global për Gratë argumenton që mbështetja e organizatave të grave është kyçe për të krijuar një shoqëri civile të qëndrueshme e cila mund të mbështes të drejtat e qytetarëve:

> Përderisa ndihmat lehtësuese janë përgjigja tradicionale e bamirësisë drejt konflikteve, Fondi Global ka një qasje tjetër. Duke forcuar organizatat e shoqërisë civile të drejtuara nga gratë, përfshirë lëvizjet e grave, për të mbrojtur të drejtat bazike të njeriut dhe mbështetjen e grave lidere, Fondi Global në mënyrë të veçantë plotëson një nevojë kyçe në vendet në konflikt. Ne po mësojmë që është e dobishme që të shkojmë përtej dhënies direkte të granteve dhe investimeve në zhvillimin e rrjeteve të këshilltarëve. Pas dekadave të financimit të këtyre rrjeteve, tani e shohim ndikimin e tyre në formën më të fuqishme, lëvizje feministe me diversitet në popullatë dhe perspektiva.

Investimi në shoqëri civile na drejton te themelimi i organizatave dhe lëvizjeve të qëndrueshme, që posedojnë aftësi si të përshtatjes e deri

[24] AWID, 2013.

tek ndërrimi i rrethanave, duke siguruar që të drejtat e grave janë të mbrojtura dhe barazia gjinore të shtyhet përpara.

Organizatat për të drejtat e grave mund të japin kontribut të madh për shtytjen e të drejtave të grave si të drejta njerëzore si avokues, mbikëqyrës, edukatorë, dhe ofrues të shërbimeve aty ku shërbimet shtetërore nuk ekzistojnë ose janë të papërshtatshme.

Së pari, avokimi si formë e veprimit luan rol të veçantë për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore. Kjo përfshin analizimin e ligjeve të propozuara dhe politikave nga një perspektivë gjinore dhe ofrimin e ekspertizës për t'i informuar ata; duke shtyrë përpara politika të reja për barazi gjinore; dhe duke monitoruar dhe mbrojtur implementimin e ligjeve, politikave, dhe angazhimeve drejt barazisë gjinore.

Për avokim efektiv, veçanërisht për ndërrime të politikave, organizatave ju nevojitet ndihma financiare për disa vite me radhë. Duke marrë parasysh gjendjen ekonomike në Kosovë, pjesa përbërëse e organizatave posedon resurse minimale. Organizatat nuk mund të marrin fonde nga qeveria *për* avokim. Një shprehje e vjetër thotë që "nuk mund të kafshohet dora që të ushqen". Për këtë arsye, organizatat për të drejtat e grave varen kryesisht nga mbështetja ndërkombëtare për iniciativat e tyre në avokim.

Një rol dytësor i organizatave të grave është transformimi i normave dhe praktikave gjinore përmes vetëdijesimit. Ato nxisin debate publike në nivele lokale dhe qendrore; promovojnë vetëdijesimin nëpërmjet fushatave, dhe në media; sigurojnë hapësira të sigurta për gratë e margjinalizuara në mënyrë që ato të shoqërohen jashtë kufijve të shtëpisë ("ngritja e vetëdijes")[25]; dhe fuqizimi individual i grave që t'i kuptojnë të drejtat e tyre.

[25] Gjithashtu i referohet si ngritje e vetëdijes, që ishte e popullarizuar në vitet e 60-ta në SHBA nga lëvizja feministe, si formë e aktivizmit politik në të cilën grupet kërkonin të kishte fokus të veçantë në një çështje të caktuar.

Së treti, në mungesë të funksionimit të shërbimeve shtetërore, organizatat e grave mbushin një boshllëk të rëndësishëm në implementimin e ligjeve përmes dispozitave shërbyese. Në Kosovë, organizatat e grave kanë shërbime të rëndësishme lidhur me dhunën me baza gjinore, këshilla për të traumatizuar, dhe shëndetësi. Strehimoret dhe qendrat për këshillim të grave ofrojnë shërbime bazike për gra dhe fëmijë. Me siguri do të duhen vite që shteti të ofrojë këto shërbime. Në ndërkohe, organizatat e grave mbushin këtë zbrastësi, dhe shteti duhet të kontribuojë më shumë për financimin e tyre.[26]

"Dhuna në familje dhe trafikimi janë në rritje. Shteti i Kosovës duhet të financojë ata të cilët i luftojnë këto probleme. Megjithatë, ne nuk kemi mbështetje të qëndrueshme nga shteti, kështu që na nevojiten donatorët." – OSHC

Për disa shërbime të veçanta, organizatat e grave kanë ekspertizën dhe eksperiencën të ndihmojnë gratë më së miri. Gratë të cilat kanë vuajtur nga dhuna, keqtrajtimi, ose diskriminimi nga institucionet publike, dhe/ose që kanë frikë nga thashethemet përbrenda komuniteteve të vogla të tyre, ndoshta më mirë do të trajtoheshin nga organizatat e grave që kanë më shumë ndjeshmëri dhe trajnim adekuat se sa nga institucionet qeveritare. Me vendndodhje në zona rurale dhe me anëtarë të ndryshëm si nga mosha, etnia, dhe aftësitë, organizatat e grave mund të jenë ndër më të lehtat për t'u qasur për ata që kanë nevojë. Kjo është e rëndësishme duke marrë parasysh që shumë gra nuk e kanë mundësinë për të udhëtuar.

"Do të ishte e pamundur të pritej ndonjë ndryshim nga programi jonë i shkrim-leximit për gratë, pa ndërhyrjen direkte të OJQ-ve të grave. OJQ-të kanë qenë partner kyç." – Donator

Ka plotë shembuj për kontributet e organizatave të grave drejt barazisë gjinore, të drejtave njerëzore, dhe zhvillimin e Kosovës në përgjithësi (shiko Kutinë 2).

[26] Shiko RrGGK, *Me cfarë Cmimi? Buxhetimi për Implementimin e Kornizës Ligjore kundër Dhunës në Familje në Kosovë*, Prishtinë: UNDP, 2012.

Kutia 2. Kontributet kryesore nga organizatat e grave

- € Strehimoret kanë ofruar shërbime në mungesë të shërbimeve shtetërore, duke ndihmuar mijëra gra dhe fëmijë.
- € Pas luftës, grupet e grave me sukses arritën të fusin kuotën e 30% brenda ligjit të zgjedhjeve. Dy herë u rrezikua heqja kuotës dhe në të dyja ishin grupet e grave që avokuan dhe me sukses e mbrojtën, së bashku me CSOs të drejtuara nga burra, për pjesëmarrjen e grave (dhe burrave) në procesin e vendimmarrjes.
- € Grupet e grave me sukses avokuan për themelimin e Agjencisë për Barazi Gjinore në nivelin më të lartë të qeverisë (jo si ministri e ndarë) drejt përfshirjes gjinore në të gjitha nivelet e qeverisë.
- € Organizatat e grave kanë ofruar konsultime dhe kanë ndihmuar integrimin dhe shërimin e grave të cilat kanë vuajtur nga dhuna seksuale gjatë luftës. Ato i kanë fuqizuar qindra gra të cilat kanë humbur burrat gjatë luftës duke i mësuar të vozisin, fillojnë biznesin e tyre, dhe të jetojnë të pavarura.
- € Medika Kosova përmes klinikës mobile gjinekologjike ka ofruar shërbime të rëndësishme për gratë të cilat nuk do të mund të kishin qasje në përkujdesje, duke përdorur një qasje psikosomatike. Ato gjithashtu kanë ofruar konsultime dhe ndihmesa duke përforcuar qindra gra që kanë trauma pas luftës.
- € Disa grupe të grave kanë bashkëpunuar në hartimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe Programit Nacional.
- € Kanë ndihmuar mijëra gra në aspekt të edukimit nëpërmjet përkrahjes për mundësinë e qasjes në arsim të lartë, duke bashkëpunuar me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe UNICEF-in.
- € Hulumtimi i RrGGK-së i bazuar në fakte ka shërbyes si mbrojtje në disa politika të reja drejt barazisë gjinore dhe të drejtave të grave (p.sh. Ligji dhe Plani Nacional për Mbrojtje kundër dhunës në familje dhe Plani Nacional për implementimin e UNSCR 1325.
- € Grupet e grave, përveç tjerash, gjithashtu kanë shtyrë për involvim të qeverisë në mbrojtje të të drejtave të komunitetit LGBT.
- € Organizatat si Qendra për Studime Gjinore e Kosovës kanë përpiluar raporte të monitorimit sa i përket implementimit të CEDAW, UNSCR 1325, nga ana e qeverisë në dhe çështje tjera.

Së paku hipotetikisht, donatorët bien dakord që organizatat e grave luajnë një rol të "rëndësishëm" në proceset e ndryshimeve shoqërore. Megjithatë, disa donatorë ndjejnë që ka mungesë të

rezultateve nga ana e organizatave të grave. “Është e vështire të dihet çfarë po bëhet dhe çfarë ndikimi po ka,” tha një donator. “Do të ishte shumë mirë po të kishim dijeni për çfarë përdoren fondet, numrin e përfituesve, shtrirjen dhe në cilat zona.” Bashkëpunëtorja e saj shtoi, “Ekziston një numër i madh i OJQ-ve, po kurrë nuk e kuptoj sa është vlera e shtuar prej organizatave të grave ... Perceptimi i donatorëve është që shumë mjete janë dhënë deri më tani për këtë çështje [gjinia, deri më tani].” Një tjetër donator u pajtua duke thënë:

> Organizatat e grave duhet të tregojnë ndikimin e tyre duke dhënë kështu bazë për këtë kauzë. Siç kuptoj nga bisedat me të tjerët donatorët nuk janë të kënaqur me efikasitetin dhe efektshmërinë në implementimin e projekteve dhe programeve nëpërmjet OSHC. OSHC duhet të arsyetojnë më mirë se si po përdoren fondet1. OJQ-të duhet të ndërtojnë kapacitetet e tyre të brendshme dhe të tregojnë rastin për fonde.

Arsye tjera përse disa donatorë hezitojnë të mbështesin organizatat e grave kanë mendim që atyre ju mungon kapaciteti, kanë strategji të papërshtatshme afatgjate, dhe mungesë ekspertize. Një donator dha vërejtje duke thënë:

> Do të kisha dashur të shoh një vlerësim më objektiv të përparësive dhe dobësive të OSHC në Kosovë [shiko Kutinë 3]. Unë kam kuptuar që shumë prej tyre janë të varura nga donatorët. Ato nuk specializohen. Nëse një donator financon parandalimin apo luftimin e dhunës ndaj grave, të gjithë fillojnë të punojnë vetëm në atë drejtim. Nëse donatori vendos të financon komunitetet etnike, prapë të gjithë fillojnë të punojnë në atë drejtim. Organizatat duhet të përparojnë duke u bërë ekspertë në një fushë të caktuar.

Përderisa disa nga këto kritika janë valide, patjetër hapen dy çështje të cilat duhen të diskutohen.

Kutia 3. Përparësitë dhe dobësitë e Organizatave të Grave

Në përgjigje të kërkesave të donatorëve, kjo tabelë përmbledh disa nga përparësitë dhe dobësitë e organizatave të grave, të identifikuara përmes këtij hulumtimi dhe vlerësimin e nevojave të identifikuar nga RrGGK në 2013.[27] *Duhet të ceket që organizatat nuk mund të gjeneralizohen; me fjalë të tjera çka janë përparësitë për disa mund të jenë dobësi për tjetrën.*

Fuqitë	Dobësitë
Avokimi: mbështetjen me sukses të disa ligjeve dhe politikave për barazi gjinore dhe të drejtat e grave si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror.	Veprime të pamjaftueshme strategjike ndër disa grupe të vogla/reja për shtyrjen e ndryshimeve politike që të *institucionalizohet* barazia gjinore.
Rrjeti: E njohur ndërkombëtarisht, RrGGK ishte vazhdimësi nga Rrjeti Rural i Grave që ishte themeluar në vitin 1995. Ka mbajtur rregullisht mbledhje çdo dy muaj dhe çdo vit që nga viti 2000. Më shumë se gjysma prej gjithsej 103 anëtareve janë pjesë aktive e shkëmbimeve të informatave, koordinimit, dhe avokimit të përbashkët.	Shumë organizata, megjithëse jo të gjitha, kanë mungesë të sistemit adekuat **administrativ dhe financiar**. Në ato përfshihen politikat menaxhuese të financave, sistem elektronik të llogarive, dhe të ardhura të mjaftueshme për të kontraktuar auditor për çdo vit.
Hulumtim i bazuar në fakte: disa nga organizatat bëjnë hulumtim kualitativ të bazuar në fakte për të informuar rreth ligjeve dhe politikave të reja	**Monitorim i pamjaftueshëm** në hulumtimet fillestare dhe gjithashtu sigurimi që rekomandimet dhe/ose arritjet të implementohen.
Rritja e vetëdijesimit në çështjet si trafikimi, dhuna në familje, dhe shëndeti, ndër të tjerash; shfrytëzimi i medieve, artistëve, evenimenteve kulturore, dhe veprimeve publike për të përçuar mesazhin.	**Përfshirje jo adekuate e publikut** (ndër të shumta) ndaj shfaqjes së rezultateve dhe në mënyrë transparente raportimit në financa, si përmes raportit vjetor
Ofrimi i shërbimeve në mungesë të shërbimeve shtetërore (p.sh. strehimoret)	**Paqëndrueshmëria:** resurse të pamjaftueshme për qëndrueshmëri afat gjate.

[27] RrGGK, *Raporti i Monitorimit të Kodit të Mirësjelljes të RrGG-së dhe Plani i Ngritjes së Kapaciteteve për Anëtaret*, Prishtina: RrGGK, 2013.

Monitorimi i implementimit të ligjeve, politikave dhe angazhimeve të reja drejt barazisë gjinore.	**Mos njohja e gjuhës angleze,** duke bërë të vështirë qasjen në fonde
Fuqizimi i grave, duke përdorur lidhje në komunitet dhe dijeninë e nevojave; duke përfshirë gratë e izoluara të cilat nuk do të takonin ndonjë tjetër përveç këtyre organizatave.	**Egocentrik:** Disa nga udhëheqësit janë më shumë të preokupuar për pozitën dhe rrogën e tyre se sa të i shërbejnë qytetarëve: kjo përfshin keqpërdorimin e fondeve, duke krijuar imazhin negativ për sektorin.
Bashkëpunimi me qeverinë duke shpie në ndryshime konkrete, përfshire në nivelin lokal (p.sh. transporti publik për gratë e fshatrave për të udhëtuar në punë apo shkollë)	**Bashkëpunim jo të mjaftueshëm** me akterët e tjerë, përfshirë dhe qeverinë, ndër to dhe disa organizata.
Bashkëpunim me burra: disa përfshijnë Policinë e Kosovës, kryetarët e komunave, ministra, parlamentarë, dhe burra në komunitete drejt ndryshimit të normave gjinore.	Disa organizata të grave nuk i përfshijnë mjaftueshëm burrat.
Strategji: Përderisa disa mund të mos kenë strategji të tyre, shumë përpiqen të implementojnë strategjinë e përbashkët të RRGGK për organizatat e grave, e cilla synon të i ngritë kapacitetet e organizatave të grave; të rrit pjesëmarrjen e grave në politikë dhe në marrje të vendimeve; përmirësoj qasjen në shërbime kualitative të shëndetit; ulje të dhunës gjinore; dhe fuqizimin ekonomik të grave	Disa kanë mungesë të strategjisë. Gjithashtu, përderisa shumica kanë marrë pjesë dhe kanë ra dakord për të ndihmuar në implementimin e planit strategjik të RRGGK, disa prej tyre mund të mos jenë aktive në këtë drejtim (p.sh. ngritjen e çështjeve përbrenda komuniteteve të tyre ose bashkimit për përpjekjet e RRGGK për avokim.
Ekspertiza ligjore: disa marrin pjesë në mënyrë aktive drejt hartimit të ligjeve të reja nga një perspektive gjinore.	

Së pari, këto kritika në mënyre të pasaktë i gjeneralizojnë organizatat e grave. Kjo mbrohet me faktin që disa donatorë i kundërshtojnë këto kritika. Njëri prej tyre tha, "organizatat e grave janë zhvilluar dhe janë bërë partner strategjik me ato se çfarë kanë synuar të arrijnë, prej ofrimit të shërbimeve e deri tek promovimi i të drejtave të grave." Organizatat e grave janë të shumëllojshme. Përderisa disa prej tyre mund të kenë mungesë të ekspertizës dhe një strategji afatgjatë, tjerat posedojnë strategji të qartë të fuqishme me ekspertizë të fituar prej më shumë se një dekadë, në sektorët e tyre (shiko Kutia 4).

Me të vërtetë disa organizata kanë mungesë të strategjive të qarta por ato duhet të inkurajohen (dhe disa herë të ndihmohen) për të krijuar qëllime të qarta para se të marrin fonde të rëndësishme. Ndërsa, organizatat e grave që kanë strategji të qarta dhe ekspertize për të ndihmuar në drejtim të të drejtave të grave dhe barazisë gjinore duhet të përkrahen. Ndoshta organizatat e grave gjithashtu mund të përmirësojnë marrëdhëniet me publikun, demonstrim më të mirë të strategjive dhe ekspertizës tek donatorët.

"Ne duhet të punojmë shumë në drejtim të edukimit të donatorëve ashtu që nevoja të kuptohet pa u nxjerrë nga konteksti, dhe jo vetëm të kuptohet, por edhe të mbështetet." - Donator

Së dyti, të kritikuarit e organizatave të grave për pjesëmarrje në iniciativa të cilat janë në agjendën e donatorëve është e padrejtë duke konsideruar natyrën e fondeve. Organizatat e grave duke u munduar të implementojn strategjitë e tyre shpesh hasin në probleme për gjetje të fondeve për çështjet që ato i shohin si prioritete (shiko Kapitullin 2). Prioritet e imponuara nga fondet e donatorëve dhe financimi afatshkurtër (për periudha prej një deri në dhjetë vjet maksimal) i kufizon shumë organizata të grave duke i bërë të humbin fokusin nga strategjitë ose fusha e ekspertizës e tyre. Disa aktivistë me keqardhje thonë që nëse nuk punojnë edhe jashtë prioriteve të tyre, ata mund edhe të shuhen si organizatë pasi që donatorët nuk do të japin fonde për prioritetet e tyre. Mundësitë ekzistojnë që organizatat për të drejta të grave të i edukojnë donatorët e tyre në lidhje me strategjitë, prioritetet, dhe faktet për nevojën për ndërhyrjen e tyre.

Kutia 4. Organizatat për të Drejtat e Grave dhe ekspertiza e tyre

Zyrtarët qeveritarë dhe media janë ankuar tek donatorët që nuk po mund t'i identifikojnë gratë në shoqërinë civile që posedojnë ekspertizë të mjaftueshme për të kontribuar në debate politike. Kjo tabelë synon të i qaset këtij problemi, të mungesës së informatës, duke i identifikuar Organizatat për të Drejta të Grave që posedojnë aftësi për të ofruar ekspertize, me më shumë se 10 vjet eksperiencë.

Organizata	Lokacioni	Ekspertiza
Qendra për Rehabilitim dhe Trajtim të Viktimave të Dhunës; Medika Kosova	Prishtinë; Gjakovë	Konsultime psikologjike profesionale për trauma dhe dhunë gjinore, duke përfshirë dhunë seksuale gjatë luftës
Rrejti i Grupeve të Grave të Kosovës	Prishtinë; me anëtarësi në Kosovë	Pjesëmarrja politike e grave dhe fuqizimi i grave; parandalimi dhe mbrojtja për dhunë në familje; analiza gjinore; avokimi; rrjetëzim; grante të vogla, vetëdijesim në nivel qendror; dhe buxhetimi të ndjeshëm gjinor
Thirrjet e Nënave	Gjakovë	Të zhdukurit: avokimi dhe ndihma psikologjike për familjet.
Mbrojtja e Viktimave, Parandalimi i Trafikimit	Prishtinë	Parandalimi i trafikimit dhe mbrojtja e njerëzve të cilat kanë qenë të trafikuar
Koalicioni i Strehimoreve	Kosovë	Mbrojtja e personave të cilët kanë vuajtur nga dhuna gjinore, veçanërisht nga dhuna në familje; strehimore; trajnime profesionale; edukimi; shëndetësia; këshilla ligjore.
Norma – Asociacioni i Juristeve të Kosovës	Prishtinë	Ndihmë ligjore; analiza ligjore prej perspektivës së gjinisë; monitorimi dhe implementimi i ligjeve dhe politikave
She-Era Asociacioni i Grave në Biznes	Gjakovë/ Prishtinë	Fuqizimi ekonomik i grave dhe përfshirja e gjinisë përbrenda politikave të zhvillimit të ekonomisë.
Qendra Kosovare për Studime Gjinore	Prishtinë	Analiza të politikave prej perspektivës gjinore; përfshirja e gjinisë përbrenda sistemit të edukimit, politikës, fondeve të EU, shërbimit publik, dhe politikave kundër ngacmimeve seksuale.
Jeta-Vita	Prishtinë	Parandalimi i kancerit, rritja e vetëdijësimit, reforma të politikave, dhe konsultimi për pacientë dhe familjet e tyre
Vita-Jeta	Prishtinë	Mbrojtjen e nevojave dhe të drejtave të pensionuarave
Asociacioni i Fermerëve të Krushës;	Krusha	Zhvillimi ekonomik i grave të fshatit, veçanërisht të lidhura me bujqësi.
Dera e Hapur	Prishtinë	Zhvillimi i kapaciteteve për shitje të produkteve të bëra me dorë nga gratë; marketing
Femra për Femra me Aftësi të Kufizuara	Prizren	Të drejtat e grave me aftësi të kufizuar

Në frymën e ndihmave efektive, efikase, dhe me menaxhment të bazuar në rezultate,[28] donatorët gjithnjë e më shumë kërkojnë fakte që fondet e tyre janë më efektivet dhe efikase për të nxjerrur rezultate. Duket e drejtë pasi që donatorët duhet të arsyetohen tek mbështetësit e tyre, zakonisht qeveritë, individët dhe/ose tatimpaguesit, përderisa mbështetja financiare ja vlen. Për atë donatorët kthehen tek grupet që ata i financojnë dhe kërkojnë fakte dhe rezultate. Ata munden të hezitojnë që ti mbështesin grupet që nuk tregojnë rezultate të qarta.

"Po bëhet gjithnjë më vështirë për të ngritur fonde. Ne duhet të jemi gati për të shpjeguar dhe të dëshmojmë rastin pse na nevojitet të mbështesim organizatat e grave." – Donator

Demonstrimi i ndikimit brenda një projekti me afat kohor paraqet një sfidë serioze për organizatat për të drejtat e grave rreth e rreth botës sepse së pari, të ndërrosh normat gjinore ose instalimi i politikave drejt barazisë gjinorë merr kohe; rrallë shohim që këto ndryshime të ndodhin brenda një projekti një vjeçar. Për më tepër, ndryshimet sociale, si ndërrimi i normave gjinore, janë shumë vështirë që të bëjmë matje, e veçanërisht me resurse të kufizuara. Ndoshta si rezultat i këtyre sfidave, intervistat sugjerojnë që shumica e donatorëve në Kosovë kanë mungesë të informacionit dhe dijenisë për punën që bëjnë Organizatat për të Drejtat e Grave dhe ndikimi që ato kanë pasur këto 13 vjetët e fundit.

Organizatat për të drejtat e grave mund të bëjnë një punë më të mirë sa i përket komunikimit me donatorë (duke përfshirë qeverinë dhe komunitetin e tyre) se si mbështetësit dhe investimet financiare prodhojnë ndryshime sociale me kohë. Aktivistet për të Drejta të Grave ndërkombëtarisht janë duke thirrur për përmirësimin e indikatorëve për matjen e ndikimit.[29]

[28] Shikoni Komisionin e Organizatës për (OECD) Ndihmë në Zhvillim "Principet për Vlerësim dhe Ndihmë në Zhvillim", Paris: OECD, 1991, dhe "DAC Kriteret për vlerësimin e Ndihmës për Zhvillim."

[29] Aktivistet e të drejtave të grave në gjithë botën po kërkojnë përmirësim në matjen e ndikimit. Shikoni AWID, 2013, faqe 130.

Në të njëjtën kohë, donatorët mund të shqyrtojnë sistemet e tyre të monitorimit dhe vlerësimit, duke siguruar që indikatorët janë të saktë si praktikisht ashtu edhe për matje të ndryshimeve sociale afatgjate. Një donator sugjeron:

> Donatorët duhet të dinë përgjegjësinë personale për të vlerësuar efektet afatgjatë të mbështetjes së tyre si të bashkuar. Nuk varet vetëm prej fondacioneve, gjë që është e pamundur pasi që ata janë si akterë të vetëm që punojnë me projekte aftat shkurtë. [Gjithashtu,] të gjithë akterët duhet të kuptojnë që rezultatet arrihen në shumë nivele, nga ai individual (p.sh. ndryshim të sjelljes), i komunitetit (p.sh. njerëzit duke bashkëpunuar), deri tek nivelet më të larta (p.sh. SHC marrja e përgjegjësisë, ndihmesa në implementim, dhe influencimi në ligje dhe rregullore). Nga të gjitha nivelet, në të ardhmen e largët do të kishte një ndryshim në shoqëri.[30]

Në përfundim, ky kapitull kishte për qëllim të "bëhet rasti" për mbështetje të barazisë gjinore dhe drejtave të grave. Përderisa donatorët bien dakord që një mbështetje si kjo është me rëndësi për zhvillimin e Kosovës, shumë vazhdojnë të kërkojnë për strategjinë më të mirë. Organizatat e grave duhen të jenë "partner natyral".[31] Përderisa disa organizata i kanë dobësitë e tyre, ato dhe të tjerat posedojnë ekspertizë të madhe në çështje specifike, eksperiencë avokimi, lidhjet e forta, lidhje me komunitete të shumëllojshme për rritje të vetëdijesimit, dhe shërbimeve profesionale kur ato mungojnë nga ana e shtetit.

Disa donatorë treguan që teorikisht më shumë fonde do të ishin në dispozicion nëse organizatat e grave do të demonstronin strategji afatgjate më të qarta, ekspertizë për çështjen, dhe ndikimi i tyre. Por e njëjta vlen edhe për donatorët, pra në qoftë se ata dëshirojnë të i financojnë në bazë të nevojave dhe të i mbështesin organizatat që kanë strategji të qarta ato duhet të i dëgjojnë organizatat dhe nevojat

[30] Komente gjatë publikimit të të gjeturave preliminare, 2 shtator 2013.
[31] AWID, 2013, faqe 24.

e tyre dhe të i fusin mekanizmat që ndihmojnë organizatat në implementim të strategjive. Donatorët munden të i shqyrtojnë monitorimet dhe sistemet e vlerësimit drejt matjes më të mirë të ndikimit.

Kapitulli 2. Ku janë paratë?

Ky kapitull shtjellon se "ku gjenden paratë për të drejtat e grave?"- para se të prezantojmë të gjeturat e hulumtimit, kapitulli na qartëson disa nga sfidat rreth mbledhjes dhe analizës së të dhënave. Më pastaj, shtjellon financimin e ndërlidhur me barazinë gjinore dhe të drejtat e grave në Kosovë, pasuar nga një vështrim më i afërt i financimit të organizatave të grave.

Sistemet e pamjaftueshme për të përcjellur shpenzimet

Rreth 377 agjencione ndërkombëtare kanë ekzistuar në Kosovë në vitin 2005.[32] Shumë prej atyre qëmoti janë larguar. Disa sosh kanë ruajtur të dhëna lidhur me financimin e ofruar në Kosovë para vitit 2008. Disa donatorë thane që nuk kanë burime njerëzore në dispozicion për t'iu përgjigjur kërkesave për informatë përkitazi me financimin e mëhershëm. Të tjerët kanë refuzuar të ofrojnë informata të tilla pasi që na qenkan "konfidenciale."

"Nuk kemi fuqi punëtore për të ofruar këtë informatë." - Donator

Identifikimi i granteve që u janë ofruar organizatave të grave u dëshmua si punë më e lehtë se sa kuantifikimi i financimit në drejtim të barazisë gjinore më gjerë. Donatorët lehtë mund t'i kuantifikojnë programet të cilat përqendrohen vetëm në përmirësimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave (p.sh. shtjellimi i dhunës në familje apo zgjerimi i pjesëmarrjes politike të grave). Mirëpo, donatorët kanë vështirësi të vlerësojnë financim në kuadër të programeve apo projekteve që kanë të bëjnë me përvetësimin gjinor (mainstreaming). Ata gjithashtu kanë vështirësi të shprehin në sasi përqindjen e kostos së tyre operative e cila i dedikohet barazisë gjinore dhe/ose programeve për të drejta të grave. Siç u shpreh një donator:

> Luteni të keni parasysh se shumat e cekura mbulojnë vetëm aktivitete specifike gjinore dhe/ose ato të projekteve të

[32] Zyra e Regjistrimit të OJQ-ve, 2005.

ndërlidhura me gra dhe jo aktivitete të cilat mund të ndikojnë në barazi gjinore në mënyrë indirekte, siç janë ato të ndërlidhura me monitorimin, raportimin, dhe avokimin përkitazi me zbatim të ligjeve, politikave, dhe planeve të veprimit ose punëtori për trajnim/avokim ku nuk janë përvetësuar çështje specifike të grave. Këto gjithashtu nuk përfshijnë kostot e shkaktuara për staf dhe ato administrative.

Posaçërisht pas përfundimit të programit, donatorët nuk mund të llogarisin përqindjen e kohës së shpenzuar nga stafi në avancim të barazisë gjinore në kuadër të një projekti më të gjerë të fuqizimit ekonomik, për shembull. Dhe as që mund të vlerësojnë përqindjen e qirasë, shërbimeve komunale, komunikimit, dhe/ose transportit të shfrytëzuar për avancim të barazisë gjinore. Donatorët nuk kanë tregues për matjen e inputeve financiare në lidhje me kuotat për pjesëmarrjen e grave në programe më të gjera.

"Ndonjëherë mbështetja financiare nuk është direkte por indirekte, dhe kjo është vështirë të matet. Nuk është çështja vetëm tek kontrata. … Ne gjithashtu, për shembull, dërgojmë organizata të grave gjetiu në botë për të fituar përvojë." - Donator

Si përmbledhje, shumica e donatorëve të intervistuar për këtë hulumtim thanë se llogaritja e kontributit financiar për avancimin e barazisë gjinore në Kosovë është e vështirë, jo e kompletuar, apo e pasaktë. Duke pasur parasysh këto sfida, ekipi hulumtues konstatoi se është e vështirë të vlerësohet financimi total i alokuar për përpjekjet e barazisë gjinore. Dhe as nuk shtjellon ky raport se cili donator ka ofruar më shumë (apo më pak) financim për shkak të kufizimeve të lartpërmendura me qasje në të dhëna dhe me premtime gjegjëse për kofidencialitetit (që pamundësuan disa donatorë që të ofrojnë të dhëna).

"Provojmë të përfshijmë çështjet gjinore në të gjitha projektet. Prandaj e kemi të pamundur të bëjmë një kalkulim të tillë." - Donator

Duke i pasur parasysh këto çështje, në kuadër të analizës që pason, ekipi hulumtues ka vënë në pah disa lëmi ku të dhënat janë të pakompletuara apo madje edhe të pasakta. Duke i pasur parasysh

zbrazëtirat në të dhënat në dispozicion, mbase është e pranueshme të sugjerohet se donatorët kanë ndarë më shumë financim për barazi gjinore dhe të drejta të grave sesa që prezantohet këtu.

Përmirësimi i sistemeve për grumbullim të të dhënave si dhe gatishmëria më e madhe në mesin e më shumë donatorëve për të ndarë informata në lidhje me shpenzimet e mëparshme do të mundësonte një analizë më të thellë në të ardhmen. Nëse donatorët synojnë të përvetësojnë barazinë gjinore gjatë punës së tyre, ata duhet të aplikojnë planifikim buxhetor i cili shtjellon barazinë gjinore, si dhe të sigurojnë se posedojnë sisteme për të llogaritur shpenzimet për barazinë gjinore.

Financimi për barazi gjinore dhe për të drejta të grave

Një burim i informimit lidhur me financimin e barazisë gjinore dhe të drejtat e grave janë shënime lidhur me Ndihmën e Jashtme Zhvillimore (Overseas Development Aid - ODA). Gjatë viteve 2001 dhe 2013, Kosova ka pranuar gjithsej €1,187,302,464 të ODA. Rreth 1.95% u është dedikuar programeve të cilat kishin për qëllim arritjen e barazisë gjinore.[33] Edhe pse informata të hollësishme për të gjitha vitet nuk ishin në dispozicion, të dhënat për tre vite mund të jenë mjaft ilustrative.

ODA raportohet bazuar në sektor dhe nën-sektor. Në vitin 2005, rreth €22,587,360 është shpenzuar për "demokraci, të drejtat e njeriut dhe shoqëri civile" i cili në ODA merr pjesë me 11.3%.[34] Kjo është shpërndarë në rend të parë për të drejtat e pakicave (27%). Zhvillimi i OJQ-ve dhe shoqëria civile ka pranuar 24% ndërsa për barazi gjinore 8% (€2,045,040). BE-ja, SHBA-të, Suedia, Zvicra dhe Holanda kanë ofruar më së shumti mbështetje, sipas Ministrisë për Integrime Evropiane. Projektet e ndërlidhura me gjini e me fokus në

[33] Ministria e Integrimeve Evropiane, *Raporti për ODA: Partnerët zhvillimor për AMP sipas sektorëve*, Prishtinë: 2012. Kjo gjithashtu dëshmohet nga raportet vjetore të Ministrisë.
[34] Ministria e Financave, *Raporti mbi aktivitetin e donatërove në Kosovë 2005,* Prishtinë: 2006, faqe 34.

ngritje të vetëdijes në mesin e institucioneve lokale si dhe "kultivimi i shkathtësive udhëheqëse tek gratë në pozita udhëheqëse për të ndikuar më mire në politika publike nga këndvështrimi gjinor." U ofrua edhe mbështetje për Planin Kombëtar të Veprimit për Barazinë Gjinore. Finlanda ka financuar projektin më të madh në lidhje me gjininë në këtë sektor, ku ka ofruar €1 milionë EUR për përfshirjen e organizatave të grave në parandalimin dhe adresimin e pasojave të trafikimit të qenieve njerëzore.

Të dhënat nga ODA sugjerojnë për një rënie të dukshme të financimit për barazinë gjinore në vitet që pasuan.[35] Në vitin 2009, shuma e përgjithshme e financimit për barazinë gjinore ishte €111,970 ose 0.33% të ODA-s së përgjithshme. Në vitin 2010, financimi për barazinë gjinore ishte vetëm 1.85% ose €1,337,132 nga gjithsej €74,545,608.

Mirëpo, të dhënat nga ODA janë jo të plota dhe jo konsistente. Për shembull, në vitin 2009, vetëm dy donatorë kanë raportuar financimin e tyre të ofruar për barazisë gjinore. Por, ky hulumtim ilustron se disa prej tyre kanë ofruar ndihmë gjatë atij viti. Më tej, të dhënat nga AMP nuk përcjellin shpenzimet e ndërlidhura me barazinë gjinore në mënyrë të vazhdueshme. Dhe as raportet vjetore në ueb faqen e AMP-së nuk përdorin ndonjë metodologji konsistente për të raportim, gjë që vështirëson krahasimin e financimit për barazi gjinore sipas viteve. Nga shtatë raportet vjetore, vetëm tre përfshijnë të dhëna për financimin për organizatat apo nismat e grave për barazi gjinore. Ministria e Integrimeve Evropiane duhet të kërkojnë raportim më konsistent për financim të barazisë gjinore.

"Patëm një strategji të mire të grumbullimit të fondeve, ose menaxhim të mirë që ka grumbulluar burime. Kjo ka ardhur jo vetëm nga ndihma bilaterale, por edhe nga Fondet Tematike përmes Nju Jorkut." - Donator

Shumica e donatorëve të intervistuar për këtë hulumtim kanë parë rritje të financimit për programe të barazisë gjinore në Kosovë ndërmjet viteve 2008 dhe 2012. Ata e atribuojnë

[35] Ministria e Integrimeve Evropiane, *Raporti i aktiviteteve të donatorëve në Kosovë 2009*, Prishtinë: 2009, faqe 24.

këtë rritje politikave të reja të cilat kërkojnë përvetësimin e barazisë gjinore në të gjitha programet dhe aktivitetet; grumbullim aktiv të fondeve; si dhe interesimit të donatorëve. "Ambasadat në Kosovë kanë shtuar interesimin për barazinë gjinore, posaçërisht ajo e Holandës, Finlandës, Norvegjisë dhe Suedisë," tha një donator.

Hulumtimi duket se konfirmon një rritje të tillë, pasuar nga një rënie në vitin 2013 (shih Grafikun 1). Grafiku përmban të dhëna që janë ofruar nga 20 prej 40 donatorëve të kontaktuar, si dhe të dhënat nga raportet e AMP-së. Shumica e donatorëve kanë ofruar të dhëna më të kompletuara për vitet 2008 deri 2012. Rënia në financim në vitin 2007 dhe 2008 mund t'i atribuohet pjesërisht të dhënave të mangëta nga AMP-ja për këto vite. Gjithsej, në periudhën ndërmjet viteve 2000 dhe 2014, donatorët kanë ndarë së paku €57,180,605 për nisma të barazisë gjinore dhe të drejtat e grave.

Grafiku 1. Fondet që kanë dhënë donatorët për barazi gjinore dhe të drejtat e grave sipas viteve, shprehur në milion Euro, 2000-2013



Lidhur me çështje specifike, donatorët kanë ofruar një mbështetje domethënëse për ndihmën pas konfliktit dhe për ndihmë humanitare menjëherë pas luftës, prej gjithsej €8,623,645. Ndërmjet viteve 2000 dhe 2014, financimin për lidershipin dhe fuqizimin e grave ka pranuar më së shumti financim, prej gjithsej €15,032,177 (shih Grafikun 2).

Grafiku 2. Financimi i njohur i donatorëve për barazinë gjinore dhe për të drejtat e grave sipas lëmisë, 2000-2014



Kundër trafikimi (€6,565,074) dhe nismat tjera që shtjellojnë dhunën e bazuar në gjini, në veçanti dhunën në familja (€5,111,717) gjithashtu kanë pranuar ndihmë domethënëse. Duke filluar nga viti 2006, donatorët kanë filluar të alokojnë resurse për avancimin e implementimit të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325 për gratë, paqen dhe sigurinë (€4,564,167). Çështjet tjera që kanë pranuar në mes €2.9 dhe €1.9 milionë përfshijnë shëndetësinë, krijimin e të hyrave, fuqizimin ekonomik të grave, si dhe arsimimin. Ndihma juridike, barazia gjinore (në kuptim më të gjerë), të drejtat e grave si të drejta të njeriut si dhe trajnimet profesionale të gjitha së bashku pranuar më shumë se €1 milionë gjatë kësaj periudhe. Në krahasim, donatorët kanë ofruar më pak financim për nisma të cilat janë fokusuar posaçërisht për pjesëmarrjen politike të grave; gratë në media; të drejtat reproduktive dhe shëndeti seksual; të drejtat e LGBT; të drejtat e grave me aftësi të kufizuara; bashkëpunimin ndër-etnik; të drejtat ekonomike dhe drejtësia; të drejtat ekonomike, të punës, shoqërore, dhe kulturore, trashëgimia dhe të drejtat pronësore; si dhe artet.

Edhe pse donatorët në përgjithësi pajtohen si financimi i barazisë gjinore dhe të drejtave të grave është "shumë i rëndësishëm," vetëm pesë nga 40 donatorë të cilët kanë marrë pjesë në këtë studim (14%) kishin *fonde të veçanta* të ndarë *posaçërisht* për avancimin e barazisë gjinore apo të drejtave të grave. Shumë më e shpejtë ishte qasja e "përvetësimit" (mainstreaming), e cila shpesh kishte edhe vija të ndara buxhetore.[36]

Sa i përket së ardhmes, donatorët kanë prirje të besojnë se financimi i ndërlidhur me barazinë gjinore do të mbetet mjaft i rregullt në vitin 2014 (natyrisht, për disa kjo nënkupton se nuk do të ketë fare). Mirëpo, disa donatorë kanë plane konkrete. Në kohën e këtij hulumtimi, disa janë në process të hartimit të strategjive të reja afatmesme apo afatgjata për mbështetjen e tyre të përgjithshme në Kosovë. Të tjerët, siç janë agjencionet e OKB-së presin vendime nga donatorët e tyre lidhur me projektet që i kanë parashtruar apo planifikojnë t'i parashtrojnë. Fakti që shumica e donatorëve më të

[36] Për diskutim lidhur me përfaqësim gjinor, shih Kapitullin 3.

mëdhenj nuk dijnë në veçanti shumën apo llojin e financimit të ardhshëm të cilën do të kenë për barazinë gjinore apo për të drejtat e grave.

Financimi për organizatat e grave

Financimi për barazi gjinore dhe të drejtat e grave jo domosdoshmërisht nënkupton edhe financimin për organizatat e të drejtave të grave. Vetëm rreth 39% të të gjithë financimit të njohur nga donatorët i ndarë për programe të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave në Kosovë u janë dedikuar organizatave të grave.[37] Në disa programme të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave, organizatat e grave nuk pranojnë financim. Në vend të kësaj, organizatat ndërkombëtare apo kontraktorët i zbatojnë programet. "Punojmë shumë pak me organizatat," tha një donator, "por kemi më shumë tendencë që drejtpërsëdrejti t'i zbatojmë aktivitetet duke përdorur stafin tonë." Me ulje të përgjithshme të ndihmës në mbarë botën, AWID-i gjithashtu ka konstatuar se organizatat ndërkombëtare kanë pirje t'u japin më shumë prioritet kostove të tyre operacionale se sa dhënies së granteve për OSHC-të.[38]

"Organizatat ndërkombëtare shpesh marrin mishin ndërsa organizatave të grave u hedhin kockat." – OSHC

Kjo qasje shpërfill Deklaratën e Parisit, ku donatorët janë pajtuar që "të shmangin, sa më shumë të jetë e mundur, krijimit të strukturave të veçanta për menaxhimin ditor dhe implementimin e projekteve dhe programeve të financuara nga ndihma." Në vend të kësaj, do të duhet të kyçnin institucionet dhe organizatat Kosovare drejtpërsëdrejti në implementim të nismave, kah autorësia, zhvillimi i kapaciteteve dhe efikasiteti.

Financimi i organizatave të grave sipas periudhave

Gjithsej, organizatat e grave kanë pranuar të paktën €39,691,148 ndërmjet 2000 dhe 2014. Grafiku 3 shfaq tërë financimin e njohur që i

[37] Llogaritja e ekipit të hulumtimit është e bazuar mbi informatat e ofruara nga 17 donatorë (2013).

[38] AWID, 2013, faqe 37. Ata gjithashtu vënë në pah se financimi i rritur për gratë dhe vajzat ka bërë që "akterë të tjerë të shoqërisë civile ta zgjerojnë punën e vet me gratë dhe vajza, edhe pse jo gjithmonë nga këndvështrimi i bazuar në të drejta" (faqe 15).

është ofruar organizatave të grave gjatë kësaj periudhë, shprehur në miliona Euro.[39]



Menjëherë pas luftës, Kosova qartazi ka hasur në një "tepricë të donacioneve," siç tha një përfaqësues i një OSHC-je. Fluksi i ndihmës humanitare, në veçanti Iniciativa e Grave të Kosovës për organizatat e grave, ka shpier në një rritje domethënëse të financimit krahasuar me periudhën e paraluftës. Dëshmitë sugjerojnë se ka ekzistuar më shumë financim se ai i prezantuar këtu, posaçërisht në vietet 2000, 2001, dhe 2004.

Grafiku 3 sugjeron se ndihma është zvogëluar ndërmjet viteve 2001 dhe 2004. Ngritja e ashpër në financim në vitin 2005 mund t'i atribuohet në rend të parë tre granteve shumë të mëdha për dy strehimore dhe një organizatë tjetër. Më pastaj financimi ra në vitin 2006, duke u rritur sërish deri në vitin 2011. Financimi i ri nga Instrumenti i Bashkimit Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR) kombinuar me disa nisma të reja për t'iu kundërvënë

[39] Të gjeturat burojnë nga hulumtimi i OSHC-ve të grave, intervistave me donatorë si dhe një shqyrtim të dokumenteve ekzistuese. Të dhënat janë kontrolluar për fakte dhe spastruar nga përsëritja.

dhunës së bazuar në gjini i ka kontribuar rritjes së financimi të përgjithshëm në sektor ndërmjet viteve 2008 dhe 2011. Që nga viti 2011, financimi ka rënë.

Në fakt, shumica e organizatave të hulumtuara (65%) thanë që kanë hetuar "rënie drastike" në financim që nga viti 2008.[40] Mesatarisht, të hyrat organizative duket të kenë rënë ndërmjet periudhës 2008 dhe 2012 (shih Grafikun 4). Të dhënat e ofruara nga 66 të organizatave të anketuara të grave sugjerojnë se të hyrat mesatare vjetore për sektorin kanë rënë nga €54,197 në vitin 2005 në €33,701 në 2010.



Anketa globale e AWID-it në vitin 2011 prej më shumë se 1,000 organizatave të grave vënë në pah "rritje të moderuar" të të hyrave të organizatave: "të hyrat mesatare vjetore janë dyfishuar ndërmjet viteve 2005 dhe 2010, duke arritur US$20,000" (€15,870).[41] Në Kosovë, të hyrat vjetore duket të jenë rritur lehtazi nga €0 në 2005 (kur 18 organizata nuk kishin pranuar kurrfarë të hyrash) në €1,630 në 2010. Dallimi thelbësor ndërmjet të hyrave mesatare dhe atyre mediane ilustron shpërputhjen në të hyrat vjetore në organizatat e

[40] Donatorët gjithashtu vërejnë rënie të financimit të organizatave të grave, edhe pse disa mendojnë se është rritur ndërsa të tjerët nuk dinë.
[41] AWID, faqe 16. Numri median është "numri në mes" përbrenda një mostre.

grave. Edhe pse disa organizata nuk kanë pranuar kurrfarë të hyrash për disa vite, disa kishin të hyra mjaft domethënëse (deri në €527,304 për një OSHC në vitin 2005).

Numri i organizatave që kanë pranuar grante gjithashtu duket të ketë rënë me kalimin e kohës (shih Grafikun 5). Në vitin 2001, të paktën 199 organizata të grave janë njohur të kenë pranuar financim, ndërsa vetëm 41 organizata të grave duket të kenë pranuar fonde në vitin 2013.

Grafiku 5. Numri i njohur i OSHC-ve të grave që kanë pranuar fonde për vitet 2000-2013



"Kemi gëzuar mbështetje më të madhe ndërmjet viteve 2003 dhe 2008, por donatorët tash kërkojnë implementim më të mirë të projekteve performancë profesionale." - OSHC

Në përgjithësi, të dhënat dëshmojnë se numri i organizatave aktive të grave është duke u zvogëluar, ku disa organizata të forta mobilizojnë pjesën më të madhe të resurseve. Përfaqësuesi i një organizate shpjegon:

> Financimi është rritur [që nga 2008], por numri i organizatave që e kanë pranuar është më i paktë. Disa shoqata punojnë më mirë, por këto janë të vogla në numër. Të tjerat nuk kanë pranuar financim dhe kanë humbur besimin.

Edhe pse disa organizata janë të pakënaqura me klimën aktuale të financimit, të tjerët çmojnë kriteret më të ashpra sipas të cilëve ata me gjasë përfitojnë: "Kriteret për aplikim janë shumë selektive, një fakt ky i cili më gëzon," tha një përfaqësues i OSHC-së. Disa

organizata më të vogla, më të reja dhe rurale shprehën keqardhje për atë që konsideruan si njëanshmëri në financimin e donatorëve në dobi të organizatave me seli në Prishtinë. “Shumë shoqata rurale janë shuar,” tha njëri. “Donatorët janë më të fokusuar në organizata të mëdha të cilat kanë kapacitete më të mëdha në operacionet e tyre. Ato në veçanti janë të fokusuar në qendër dhe në hartim të politikave.”

Në fakt, rreth 50% e të gjithë financimit të njohur të siguruar për grupet e grave ndërmjet viteve 2000 dhe 2013 duket t’i ketë shkuar organizatave me seli në Prishtinë (shih Grafikun 6). Edhe pse këto organizata kanë selinë në Prishtinë, disa sosh kanë zhvilluar aktivitetet e tyre në komunat tjera.

Grafiku 6. Fondet e njohura të organizatave të Grave sipas Komunave në milionë Euro, 2000-2013



Që nga viti 2010, organizatat e grave që kanë operuar në Mitrovicë kanë qenë dëshmitarë të rritjes domethënëse në financim (shih Grafikun 7).

Grafiku 7. Financimi i njohur total në milionë Euro për OSHC-të e Grave në tre komunat sipas viteve, 2001-2012



"Donatorët janë të fokusuar në Mitrovicë," tha përfaqësuesja e një organizate të grave. "Kur është fjala për pakicat, ata u japin vetëm pakicës Serbe." Në fakt, në krahasim, organizatat e udhëhequra nga gratë Boshnjake, Rome, të Ashkalinjëve, Egjiptase, Turke dhe Gorane të gjitha kanë përfituar burime të kufizuara krahasuar me homologët e tyre Shqiptarë e ndonjëherë edhe Serbë (shih Grafikun 8). Grafiku ilustron shumën e financimit të ofruar organizatave *të udhëhequr* nga personat e përkatësisë së dhënë etnike. Mirëpo, disa organizata të udhëhequra nga shqiptarët kanë bashkëpunuar me si dhe/ose kishin në shënjestër gratë nga grupet tjera etnike përmes programeve të tyre.[42]

Grafiku 8. Fondet e njohura për OJQ-të e Grave sipas etnisë, 2000-2013



Ndërmjet viteve 2000 dhe 2013, organizatat e grave kanë pranuar rreth 43% të të gjitha të hyrave nga donatorët bilateralë (p.sh. ambasadat, qeveritë e jashtme), ndonjëherë të shpërndarë përmes organizatave ndërkombëtare. Ashtu siç ilustron Grafiku 9, 24% e të gjitha të hyrave nga organe shumëpalëshe (p.sh., agjencionet e OKB-së, BE), 14% organizata ndërkombëtare joqeveritare (ONJQ) 9% e fondacioneve, 6% nga Qeveria e Kosovës, 2% nga OJQ-të tjera lokale në Kosovë, 2% nga grupet fetare, dhe më pak se 1% nga sektori privat, individë, dhe kontribute në naturë, respektivisht.

[42] Shih Shtojcën 4, Grafiku 19. Nuk kemi pasur informacione të mjaftueshme për të identifikuar se në cilat programe janë fokusuar grupe të ndryshme etnike.

Grafiku 9. Financimi i njohur për OSHC-të sipas llojit të donatorit, 2000-2013



Organizatat e grave në Kosovë pranojnë pjesën më të madhe të fondeve të tyre nga donatorët ndërkombëtare (rreth 89%). Më pak se 10% të organizatave të anketuara kanë raportuar pranim të të hyrave nga individë, asete, anëtarësi, ose aktivitete që krijojnë të hyra. Gjatë këtyre 14 viteve, vetëm €17,340 të hyra nga totali janë fituar nga kontributet në ambient ose ato vullnetare. Mirëpo, edhe pse disa organizata kanë raportuar vullnetarizëm domethënës, të paktë prej tyre kanë mundur ta përcaktojnë shumën monetare. Vlen të ceket që nga organizatat e anketuara, 24% *asnjëherë* nuk kishin pranuar fonde nga donatorët, përfshirë individë apo organe qeveritare. Disa kanë raportuar se punojnë pa të hyra me muaj të tërë apo madje edhe me vite.

Organizatat e grave kanë filluar të diversifikojnë burimet e të hyrave në disa vitet e fundit (shih Grafikun 10). Mesatarisht, organizatat kishin vetëm 1.2 donatorë në vitin 2000, por kjo është rritur në 2.7 donatorë

në vitin 2012. Disa organizata kanë raportuar madje edhe deri në dhjetë donatorë në vitet e kaluara. Këtu shpesh përfshihen bizneset lokale dhe organet qeveritare, përveç burimeve ndërkombëtare të financimit.

Grafiku 10. Numri mesatar i donatorëve për OSHC sipas viteve, 2000-2012



Prioritetet e financimit për organizata dhe çka financohet

Shumica e organizatave të anketuara të grave (71%) e konsiderojnë Fuqizimin Ekonomik të Grave si prioritet më të lartë (shih Grafikun 11). Disa grupe të grave prioritizuan qasjen në shkollim (56%), dhunën e bazuar në gjini, përfshirë dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje (44%), shëndetësi (36%), si dhe të drejtat ekonomike, shoqërore, dhe kulturore (27%). Një e pesta e organizatave të grave prioritizuan ndërtimin e paqes dhe shtjellimin e dhunës kundër grave (DHKG) në situatat e konfliktit/pas-konfliktit, të drejtat e grave me aftësi të kufizuara, lidershipin e grave dhe fuqizimin si dhe të drejtat e punës.

Më pak organizata identifikuan trafikimin me qenie njerëzore (11%), artin dhe kreativitetin (10%), pjesëmarrjen politike (7%), të drejtat reproduktive dhe shëndetin (përfshirë kontraceptivët, abortin dhe shëndetin maternistik, 7%), punën humanitare, grate në media, teknologji informative dhe të komunikimit (TIK), të drejtat ambientore dhe drejtësia, shëndeti seksual (përfshirë HIV/AIDS), të drejtat seksuale, demokracia, qeverisja, mikro-kreditë, mikro-financat, të drejtat e trashëgimisë, buxhetimi me përfshirje të aspektit gjinor, si dhe mbështetjen psiko-sociale si prioritet. Është me interes se në kohën e këtij hulumtimi, asnjë organizatë e grave nuk ka konsideruar punën e ndërlidhur me të drejtat e komunitetit LGBT, të drejtat e tokës, fenë apo migracionin si prioritet.

Grafiku 11. Çështjet që prioritizohen nga OSHC-të e grave në vitin 2013



Vetëm 24% të organizatave të grave thane që i tërë buxheti i tyre vjetor për vitin 2011 ka shkuar për çështje të cilat ata i konsiderojnë si prioritete. Për dallim, 58% thanë se nuk kanë pranuar kurrfarë financimi në vitin 2011 për ndonjë çështje që kanë prioritizuar. Disa organizata mendojnë se "donatorët nuk i shikojnë prioritetet e shoqatave, por vetë i përzgjedhin prioritetet."

Pjesa më e madhe e financimit të organizatave të grave në 14 vitetet e fundit (29% dhe së paku €11.43 milionë) ka shkuar për shtjellimin dhunës së bazuar në gjini, përfshirë dhunën në familje.[43] Ashtu siç ilustrohet me Grafikun 12, ndihmë për gratë për t'u ballafaquar me traumë dhe dhunë seksuale të përjetuar gjatë luftës (€4.32 milionë), lidershipi dhe fuqizimi i grave (€2.79 milionë), aktivitete fitim-prurëse (€2.75 milionë), mbështetje e përgjithshme organizative (€2.64 milionë), si dhe të drejtat e grave si të drejtat e njeriut (€2.48 milionë) kanë pranuar 11% deri 6% të financimit, respektivisht. Të gjitha çështjet tjera kanë pranuar më pak se 4% të fondeve të shpërndara për organizatat e grave ndërmjet viteve 2000 dhe 2014.

"Përpiqemi të mbesim në të njëjtat sektorë me kalimin e kohës, kah kontinuiteti. Ne shohim ndryshimin si diçka evolucionare dhe jo revolucionare." - Donator

Se cilat çështje marrin financim ndryshon me kohë. Jo befasisht, ndihma humanitare ishte në dispozicion menjëherë pas luftës, por është zvogëluar pas vitit 2005. Nismat për shtjellimin e dhunës së bazuar në gjini ka pranuar burime, në veçanti që nga viti 2010. Mbështetje për aktivitete fitim-prurëse ishte *masovikisht* në dispozicion gjatë fazës emergjente (në masë të madhe përmes Iniciativës së Grave të Kosovës), por ka rënë dukshëm pas vitit 2002, duke u ngritur sërish në vitin 2011 me fokus në Mitrovicë.

[43] Vlen të ceket se disa çështje janë të ndërthurura. Disa programe kombinojnë ndihmë psikosociale, mbështetje të grave të cilët kanë përjetuar dhunë gjatë luftës, dhe aktivitete fitim-prurëse, për shembull. Ekipi hulumtues ka përzgjedhur qëllimin parësor. Jo i gjithë financimi është i përfaqësuar pasi që të paktën pesë organizata të mëdha të grave nuk i kanë ndarë informatat e tyre financiare. Duke marrë parasysh mandatet e tyre, ekipi hulumtues parashtron hipotezën se financimi shtesë ka shkuar në drejtim të shtjellimit të dhunës familjare, kundër trafikimit, pjesëmarrja politike e grave, si dhe veprimtaritë fitimprurëse.

Grafiku 12. Shuma e përgjithshme në Euro për Organizatat e Grave sipas çështjeve 2000-2014



Edhe pse financimi që organizatat kanë pranuar ndërthurret në disa lëmi me prioritetet e tyre (p.sh. dhuna e bazuar në gjini, ndërtimi i paqes, si dhe lidershipi i grave), gati çdo organizatë e grave e anketuar ka shprehur brengosjen se ato nuk pranojnë financim të mjaftueshëm për çështjet që i konsiderojnë si prioritare.[44] "Ne, si OJQ-të e tjera, ballafaqohemi me problem në financim," tha një aktiviste. "Fondet për gra janë të pakta, dhe është e pamundur të përmbyllen aktivitetet."

"Nevojat janë më të mëdha se fondet që posedojmë." - OSHC

Për disa çështje, si dhuna në familje dhe kundër-trafikimi, aktivistët e të drejtave të grave theksojnë se qeveria në veçanti ka përgjegjësi ligjore që të rris mbështetjen e vet financiare. Një aktiviste tha, "Qeveria është përgjegjëse dhe duhet të krijojë një fond special për këtë çështje. Nuk duhet të jetë obligim vetëm i OJQ-ve që të mbrojnë viktimat." Edhe pse institucionet kanë filluar të ofrojnë mbështetje financiare për strehimore që ndihmojnë personat të cilat kanë vuajtur nga dhuna e bazuar në gjini, aktivistët besojnë se mbetet i pamjaftueshëm.[45]

Organizatat gjithashtu kanë prirje të mendojnë se u mungon financimi i duhur për strategjitë e tyre të preferuara. Strategjitë të cilat i parapëlqejnë shumica e organizatave të grave përfshijnë vetëdijësimin (89% e identifikojnë këtë si prioritet) dhe fuqizimin e grave (87%) (shih Grafikun 13). Disa organizata prioritizojnë trajnimin, ngritjen e kapaciteteve (71%), avokimin, zhvillimin e fushatave, lobimin (64%), si dhe ofrimin direkt të shërbimeve (44%). Më pak se një e treta prioritizojnë hulumtimin, dokumentacionin, takimet, si dhe zhvillimin e lidershipit si strategji.

[44] Anketa globale e AWID-it arriti në po të njëjtin konstatim (2013).
[45] Shiko RrGGK, *Me çfarë çmimi?*

Grafiku 13. Strategjitë me prioritet për OSHC



Edhe pse disa organizata theksuan rëndësinë e anëtarësisë së tyre në IGK, vetëm 4% marrin e konsiderojnë rrjetizimin dhe 1% krijimin e lëvizjes si strategji prioritare. Duke marrë parasysh statusin financiar të shumicës së organizatave, ndoshta nuk është e befasishme se vetëm 1% e konsiderojnë mobilizimin e resurseve si strategji. As reformat ligjore apo në politika (8%), komunikimi, ndarja e informatave (8%), apo marrja e masave direkte siç janë demonstratat (7%) prioritete për shumë organizata. Ky konstatim duket në kontrast të gjerë me popullaritetin e avokimit (64%), duke marrë parasysh se këto strategji mund të jenë pjesë dhe pako e avokimit efektiv. Sidoqoftë, 58% të

organizatave nuk kanë pranuar kurrfarë financimi në vitin 2011 për strategjitë e tyre të preferuara, ndërsa 26% të të anketuarve kanë shfrytëzuar financimin për strategjitë e tyre të parapëlqyera.

Edhe një trend tjetër përsëritës në mesin e organizatave të grave është që ato nuk pranojnë ndihmë të mjaftueshme për grupet e tyre prioritare. Ashtu siç ilustron Grafiku 14, 63% e organizatave të grave u japin prioritet punës me gratë që jetojnë në zona rurale.

Grafiku 14. Grupet cak të cilat OSHC-të e Grave i kanë prioritizuar në vitin 2013



Mirëpo, këto grupe duket të jenë në mesin e më pak të financuarve; 57% e grupeve të grave të cilat u japin prioritet punës me gra rurale nuk kanë marrë mbështetje financiare në vitin 2011. Ngjashëm 58% të organizatave të grave i konsiderojnë të rinjtë dhe fëmijët si grup i tyre cak, por 63% e tyre nuk kanë pranuar financim për këto grupe në vitin 2011. Gratë që vuajnë nga dhuna familjare prioritizohen nga 43% të organizatave. Edhe pse financimi duket të jetë më shumë në dispozicion për këtë çështje, 47% ende raportojnë se nuk kanë pranuar financim të tillë në vitin 2011. Në përgjithësi, 53% e të anketuarve thanë se nuk kanë pranuar ndonjë financim për grupet e tyre cak prioritare në vitin 2011, ndërsa 34% thanë se i gjithë financimi i tyre ka shkuar në drejtim të grupeve të tyre prioritare.

Ndikimi i rënies në financim

Rënia e qasjes në financim me kalimin e kohës nënkuptoi se 43% të organizatave të grave në vitin 2010 dhe 51% në vitin 2012 nuk e kanë përmbushur buxhetin e tyre ideal, të planifikuar. Mesatarisht, këto organizata nuk përmbushën buxhetin e tyre për shifrën marramendëse prej 74% në vitin 2010 dhe 80% në vitin 2012.[46]

"Donatorët preferonin të punonin me organizata në Prishtinë, dhe kjo ishte pjesërisht për shkak të infrastrukturës." – OSHC

Që nga viti 2008, 14% e organizatave të grave kanë humbur mbështetjen financiare nga donatorët të cilët ose historikisht i kanë mbështetur ose kanë bërë zotim që t'i mbështesin por që janë tërhequr më vonë. Si rezultat i kësaj, organizatat thanë se nuk kanë mundur t'i realizojnë aktivitetet dhe nuk kanë mundur të paguajnë pagat e stafit. Një shembull:

> Shoqata Gratë për Gratë ka ndihmuar organizatën tonë. Për tre muaj, ato kanë ofruar pajisje për ne dhe na kanë aftësuar për përpunim të drurit (kuti për koshere, lodra të drurit për fëmijë, tabela dhe karriga për kopsht). Pastaja ato u tërhoqën dhe i morën pajisjet për përpunim të drurit me vete.

[46] Vetëm një organizatë në vitin 2010 dhe dy në 2012 i kanë tejkaluar buxhetet e tyre të parashikuara.

Një projekt i cili u ofronte grave rurale të prekura nga lufta dhe të margjinalizuara shkathtësi me të cilat ato do të mund të mbijetonin, ka marrë asete në vlerë prej më shumë se €2,000, përfshirë pajisjet kyçe të përpunimit të drurit të domosdoshme që ato t'i përdorin shkathtësitë e tyre. Pa asete ose kolateral për kreditë bankare me interes të lartë, gratë nuk kanë mundur ta zëvendësojnë këtë pajisje dhe prandaj as nuk mund t'i përdorin shkathtësitë e veta për të krijuar të hyra. Mbesin të varfëruara dhe të zhgënjyera me këtë mundësi të humbur. Kthimi i aseteve të ndërlidhura me projektin është mjaft i shpeshtë, por mund të ndikojnë negativisht grupet të cilat donatori synon t'i mbështesë, ashtu siç e ilustron ky shembull.

Në përgjithësi, 70% të organizatave të grave kanë raportuar burime të pamjaftueshme në momente të caktuara në historinë e organizatës së tyre. Si rezultat, 30% e të gjitha organizatave duhet të zvogëlonin stafin; 42% të ndërprejnë programe, projekte dhe/ose aktivitete; në 51% stafi ka punuar pa paga me muaj apo me vite; dhe 3% i kanë mbyllur përkohësisht organizatat. Dy organizata nuk kanë pranuar financim që nga viti 2000, dhe kanë punuar vullnetarisht që atëherë. Organizatat e grave thanë se financimi i pamjaftueshëm kishte disa efekte negative në punën e tyre:

- € Kursime të ulura në organizatë
- € Cilësia e ulur e ndihmës së ofruar
- € Numri i zvogëluar i grave të strehuara
- € Stafi ka përdorur burimet e veta (p.sh., veturat personale)

"Planifikojmë ta mbyllim pasi që s'kemi fonde." - OSHC

Për shkak të financimit të pamjaftueshëm, 36% e organizatave të grave janë rrezikuar nga mbyllja. "Nuk mund t'i paguanim faturat e rrymës dhe duhet ta mbyllnim për shkak se shoqata nuk kishte kushte elementare për punë," tha një i anketuar. Disa organizata duhet t'i mbyllnin dyert përkohësisht për periudha të caktuara, ndërsa 42% prej tyre njohin organizatat që është dashur të mbyllen që nga viti 2008. Në një rast të veçantë, kjo kishte pasoja të rënda për gratë dhe fëmijët që vuanin nga dhuna e bazuar në gjini, pasi që duhej të flinin në stacion policor sepse s'kishin ku të

shkonin.[47] Situatë e njëjtë u paraqit edhe me personat të cilët ishin trafikuar.

Disa organizata frikësohen se do të detyrohen të mbyllen në të ardhmen e afërt. Njëra komentoi:

> Që nga viti 1995, asnjëherë nuk kemi qenë në rrezik mbylljeje. Mirëpo, tash ai rrezik është i pranishëm. Pa fonde, nuk mund të funksionojmë në mënyrë vullnetare. Organizata jonë ka punuar dy dekada, ashtu që është e dhimbshme të përjetojmë fundin e financimit pas gjithë atij përkushtimi, punës vullnetare, dhe profesionalizmit. Në të gjitha fshatrat [e komunës sonë], ne jemi të vetmit që ofrojmë mbrojtje për gratë.

Qëndrueshmëria

Ashtu siç ilustron Grafiku 3 më lartë, financimi i ardhshëm për organizatat e grave mbetet i paqartë. Vetëm pesë donatorë planifikojnë fonde për organizatat e grave pas vitit 2013. Nëse financimi do të rritet, zvogëlohet, apo të mbetet i njëjtë varet nga donatori. Edhe pse një donator relativisht më i vogël do të rris pak mbështetjen, dy donatorë më të mëdhenj do ta zvogëlojnë mbështetjen e tyre në vitin 2013 dhe 2014. Disa të tjerë e nuk e dinë se çka do të ndodh në të ardhmen, pasi që aktualisht janë në finalizim të strategjisë së tyre për Kosovën dhe presin informata nga mbështetësit e tyre. Kështu, qëndrueshmëria e financimit nga burimet ndërkombëtare për organizatat e grave mbetet e pasiguritë.

"Do të kemi të holla për organizata të grave, por nuk jemi të sigurtë sa ose si do t'i mbështesim." - Donator

Duke qenë se shumica e organizatave të grave varen në ndonjë formë nga mbështetja ndërkombëtare, e kanë të vështirë të sigurojnë qëndrueshmërinë e vet financiare apo të ndërmarrin planifikim afatgjatë financiar kur donatorët nuk e dinë se çka do të sjell e ardhmja. Kjo gjithashtu shtron pyetjen: nëse disa programe madhore

[47] RrGGK, *Hulumtimi kërkimor mbi nivelin e dhunës ne baza gjinore në Kosovë dhe ndikimi në shëndetin riprodhues të grave,* Prishtinë: RrGGK, 2008, fq. 62, në: http://www.womensnetwork.org/documents/20130204170213282.pdf.

të donatorëve janë të paqëndrueshme, si mund të presin organizata të nën-financuara të grave të kenë plane të qarta të qëndrueshmërisë?

Në Kosovë, donatorët rregullisht kërkojnë plane të qëndrueshmërisë nga organizatat, dhe 52% e organizatave të grave thonë se kanë plan rezerv në rast se organizata e tyre nuk siguron të hyra të mjaftueshme. Dy strategjitë për mbijetesë të cilat organizatat e grave i përmendin më së shpeshti janë vullnetarizmi (shumë organizata tashmë punojnë falë vullnetarizmit); dhe krijimi i të hyrave përmes shitjes së produkteve të punuara me dorë nga gratë (p.sh., punëdore dhe ushqim). Në disa organizata gratë merren me prodhime bujqësore, prodhime të qumështit, si dhe të punimeve të prodhuara me dorë. Strategjitë e tjera që organizatat përmendin përfshijnë kontributin e tyre personal, pagesa të anëtarësisë, grumbullimi i fondeve në nivel individual, kërkesat tek bizneset, ofrimi i shërbimeve me honorar (p.sh., trajnimi), mbështetje qeveritare, shfrytëzimi i rezervave, si dhe qiraja e objekteve.

"Kemi hapur një dyqan zanati, me shpresë se shitja e produkteve do t'i ndihmojë shoqatës." – OSHC

Një tregues i qëndrueshmërisë janë kursimet dhe rezervat që i posedon një organizatë dhe të cilat mund t'i shfrytëzojë që të mbijetojë. Ndërmjet vitit 2010 dhe 2012, disa organizata kanë krijuar kursime: përderisa 89% të organizatave të grave nuk kanë poseduar kursime apo rezerva në fund të vitit 2010, 86% janë ballafaquar me të njëjtën situatë në vitin 2012. Në mesin e organizatave të cilat poseduan kursime, shuma është ngritur nga mesatarisht €3,450 në 2010 në €4,104 në vitin 2012. Mirëpo, ekziston dallim i dukshëm, që sillet prej €40 deri €15,000, varësisht prej organizatës.

Nëse nevojitet, 79% të organizatave të grave thanë se kanë asete të cilat mund t'i shkëmbejnë për të holla të gatshme për të mbështetur organizatat e tyre. Asetet përfshijnë inventare, pajisje dhe vetura (shih Grafikun 15).

Grafiku 15. Asetet që i posedojnë OSHC-të e grave në vitin 2013



Mesatarisht, asetet e OSHC-ve ishin €16,933 në vitin 2010, duke u rritur në €24,512 në 2013. Mirëpo, kjo rritje mund t'i atribuohet disa zërave; më shumë se 83% e organizatave kishin asete në shumë prej më pak se €10,000.

"Kemi mbyllur zyrën dhe kemi dhënë inventarin e zyrës në zbatim të qiras që kemi pasur borxh. … Punojmë në baza vullnetare." – OSHC

Shumë organizata të grave janë mësuar të punojnë pa pagesë apo zyre, që ndoshta shpjegon se pse shumë prej tyre vazhduan së funksionuari pa fonde. "Nuk kemi pasur financim stabil," një aktiviste komentoi, "vetëm kontribute nga individë, komuna, dhe IGK." Më shumë se gjysma thanë se mund të punonin të paktën një muaj me kursime dhe rezerva (shih Grafikun 16). Mirëpo, një e treta nuk dinin nëse organizata e tyre do të mund të mbijetojë.

Grafiku 16. Sa gjatë Organizatat e Grave do të mund të operonin pa Fonde



Gjysma e organizatave të grave të anketuara nuk kanë siguruar fonde për vitin 2013, ndërsa më shumë se 76% nuk kanë siguruar buxhetin e tyre për vitin 2014. Gati gjysma nuk janë të sigurtë nëse buxheti i tyre vjetor do të rritet, zvogëlohet apo të mbetet i njëjtë në vitin 2015, krahasuar me vitin 2010. Fakti që disa organizata kanë siguruar fonde thekson bazamentin e pasigurtë mbi të cilin mbijetojnë organizata të grave. Në këtë kontekst, organizatat e grave duhet të vazhdojnë të diverisikojnë resurset e tyre, përfshirë identifikimin e burimeve të reja të financimit për qëndrueshmërinë e tyre afatgjate.[48]

Idetë për mobilizim të resurseve

Parashtrimi i projekt propozimeve është në mesin e "strategjive" të vetme të organizatave të grave për mobilizim të resurseve. Strategjitë e tjera përfshijnë takime me dhe/ose avokim tek donatorët për financim, mirëpritja e donatorëve në vizitë zyreve apo aktiviteteve të tyre, kontrollimi i ueb faqeve për mundësi financimi, paraqitja në media, si dhe bashkëpunimi me sektorin privat, organe qeveritare dhe/ose organizata të tjera. Organizata të grave mund të jenë më aktive në takime me donatorë, prezantimin e dëshmive mbi nevoja, dhe shpërndarja e materialeve të marrëdhënieve me publikun mbi punën e tyre, përfshirë edhe shembuj të ndikimit të mëhershëm (p.sh., përmes raporteve vjetore).

"RrGGK është shumë i nevojshëm sepse na njoftojnë shpesh për mundësitë për mbështetje dhe ofron bashkëpunim mes organizatave." – OSHC

Shumica e organizatave të grave kërkojnë informata mbi strategji për ndarjen e burimeve, njohtim më të mirë mbi gjendjen e financimit të organizatave të grave, dhe mundësitë për bashkëpunim me organizata të tjera të grave në drejtim të mobilizimit të resurseve, përfshirë avokimin për mobilizim kolektiv. Ato gjithashtu kërkojnë mundësi për t'u takuar dhe për të bashkëpunuar me donatorë.

Si përfundim, edhe pse financimi duket të jetë në dispozicion për barazinë gjinore dhe për të drejtat e grave, financimi jo gjithmonë arrin tek organizatat e grave. Organizatat për të drejtat e grave

[48] AWID, 2013, faqe 34.

shpesh kanë ekspertizë, përvojë dhe lidhje të mira me komunitetin e tyre. Disa sosh shfrytëzojnë resurse në mënyrë më efektive dhe efikase sesa sektori privat apo organizatat ndërkombëtare, të cilët shpesh kanë kosto më të larta operative dhe administrative. Ashtu siç ka konstatua AWID-i, "me këtë bisedë dinamike për gra dhe vajza … detyra që parashtrohet është të ndikohet në mënyrën se si do të zbatohet kjo axhendë për të siguruar se kjo nënkupton më shumë burime në duart e grave."[49] Në vend të që fokusohen në zgjidhje të shpejta që shpesh shpërfillin barriera ndaj barazisë gjinore, donatorët duhet të marrin parasysh mbështetjen e organizatave të të drejtave të grave të cilat synojnë punë afat-gjate të bazuar në të drejta të cilat shtjellojnë shkaqe thelbësore të pabarazisë gjinore duke ndryshuar normat sociale.

[49] AWID, 2013, faqe 34.

Kapitulli 3. Trendet e financimit

Ky kapitull i shqyrton trendet që ndikojnë financimin që është në dispozicion për barazi gjinore dhe të drejtat e grave, po ashtu për organizatat e grave më konkretisht.

Strategjitë e donatorëve dhe politikat e vendit

Intervistat e zhvilluara tregojnë se strategjitë e donatorëve janë faktori kryesor që ndikon vendosjen e prioriteteve për financim. Për identifikimin e nevojave dhe përpilimin e strategjive të tyre, donatorët konsultohen me përfituesit. Disa kanë bërë vlerësim të nevojave. Disa kanë synuar që të përshtatin strategjitë e tyre me prioritetet zhvillimore që janë identifikuar nga Qeveria e Kosovës.

"Shpresojmë se buxheti jonë do të vazhdojë të mbetet i njëjtë. Megjithatë, ju kurrë nuk e dini nëse ata do e shkurtojnë buxhetin … është politikë." – Donator

Sikurse edhe është e pritshme, politika vendore ndikojnë në prioritetet strategjike të agjencive zhvillimore të vendeve të huaja. Kjo përfshinë prioritetet politike, hapësirat gjeografike të interesit, dhe/apo gjendjen ekonomike të vendit të tyre.[50] Për shembull, një donator ka shpjeguar se qeveria e tij përpiqet të shtyjë përpara zbatimin e UNSCR 1325. "Ne kemi pasur mundësi që të referohemi aty për të kërkuar fonde për barazi gjinore, posaçërisht pasi që Ministri i Punëve të Jashtme është grua dhe ajo e shtyn përpara 1325-shin."

"Ne udhëzohemi në punën tonë nga strategjitë e politikave zhvillimore. Ne mundohemi të kombinojmë këto me nevojat në terren, prioritetet e qeverisë tonë, dhe prioritetet e qeverisë të vendit ku veprojmë." - Donator

Vullneti i tillë politik ndikon në angazhimin drejt barazisë gjinore. Qeveritë të cilat konsiderojnë se avancimi i barazisë gjinore është prioritet, sigurohen që agjencitë e tyre për zhvillim kanë financim për këtë çështje. Konventat ndërkombëtare dhe prioritetet zhvillimore (p.sh. CEDAW, MDG, Platforma e Pekinit për Veprim, dhe UNSCR 1325) po ashtu janë

[50] Për një diskutim rreth ndikimit të krizës ekonomike të vitit 2008 në financimin e organizatave të grave, shih AWID, 2013.

udhëzues për vendosje të prioriteteve të financimit nga ana e donatorëve.

Përfshirja e Çështjeve Gjinore

Përderisa disa donatorë kanë programe dhe fonde të veçanta për të avancuar barazinë gjinore dhe të drejtat e grave, shumë prej tyre synojnë që çështjet gjinore t'i përfshijnë në programe dhe projekte. Njëjtë, disa i referohen çështjeve gjinore si çështje "ndër-sektoriale" apo "tërthortë". Një donator ka treguar se:

> Përfshirja e çështjeve gjinore për organizatën tonë është shumë e rëndësishme. ... Ekspert jonë për çështje gjinore e shikon secilin projekt nga perspektiva gjinore dhe projektet kanë më shumë pikë në qoftë se përfshijnë edhe perspektivën gjinore. Rëndësia e përfshirjes së çështjeve gjinore është rritur. Më përpara ka qenë vetëm një ushtrim për të vendosur një shenjë. Tani kemi ekspertë të vërtetë brenda organizatës që merren me këtë punë.

Përgjatë kësaj kohe, donatorët kanë parë përmirësim në përfshirjen e çështjeve gjinore. Praktikat, mjetet, dhe procedurat që donatorët përfshijnë për të përfshirë çështjet gjinore përfshijnë: kuota gjinore (p.sh., për pjesëmarrjen e grave në aktivitete); mbledhja e të dhënave programatike të zbërthyera sipas gjinisë; treguesit gjinor për të përcjellur nivelin e kontributit të programeve sa i përket barazisë gjinore (shih kutinë 5); indikatorët për ndjeshmërinë gjinore në monitorim dhe vlerësim; raportim të rregullt sa i përket nivelit të kontributit të aktiviteteve të tyre në avancimin e barazisë gjinore; mirëmbajtja e balancës gjinore brenda zyrës; duke përfshirë kriteret gjinore në proceset e rekrutimit; dhe instalimi i pikave të kontaktit të cilat kanë për detyrë përfshirjen gjinore.

Shumica e donatorëve përdorin përfshirjen e çështjeve gjinore në programim por jo edhe në buxhetim. Në mënyrë që të bëhet siç duhet, përfshirja e çështjeve gjinore duhet të përfshijë edhe buxhetimin që i përgjigjet çështjeve gjinore: përfshirjen e çështjeve

gjinore në buxhet. Duhet të mirret parasysh se si zgjedhjet e caktuara buxhetore mund të ndikojnë ndryshe tek gratë dhe burrat.

Kutia 5. Një shembull sa i përket përfshirjes gjinore

Agjencitë e OKB-së kanë bërë përpjekje për të matur më mirë përfshirjen e çështjeve gjinore në projekte dhe programe. Që nga 2010, një komitet vlerësues i OKB-së ka përdorur "tregues gjinor" në shqyrtimin dhe komentimin e secilit projekt dhe program nga perspektiva gjinore para dorëzimit të kërkesës për financim. Të gjitha projektet duhet të ndajnë së paku 15% për barazi gjinore, si pjesë e sistemit të tyre të kontabilitetit ATLAS. Megjithatë, ata vazhdojnë të punojnë në zgjidhjen e disa sfidave. Për shembull, sistemi mundet të mat vetëm rezultatet specifike të barazisë gjinore. Prandaj, nuk mundëson matjen e të gjitha inputeve financiare që ndërlidhen me avancimin e barazisë gjinore.

"Shumicën e rasteve përfshirja e çështjeve gjinore nuk zbatohet." - Donator

Disa donatorë kanë thënë se përfshirja e çështjeve gjinore mund të ndodhë se nuk bëhet gjithmonë mirë. Për shembull, njëri nga ta thotë se punëtorët kanë mungesë të njohurive adekuate dhe ekspertizës në rishikimin dhe vlerësimin në qoftë se implikimet gjinore merren parasysh sa duhet në propozimet për projekte që i pranojnë. Intervistat me pikat e kontaktit për çështje gjinore brenda organizatave donatore sugjerojnë ngjashëm, ku disa kanë mungesë të njohurive se çfarë nënkuptohet me përfshirje të çështjeve gjinore. "Në disa raste, ju mund të shikoni një sektor ku ju nuk mund të shikoni për çështje gjinore," thotë një nga personat që shërben si pikë kontakti për çështje gjinore. "Në këtë rast, ju bëni analizat dhe ju thoni se nuk ka asgjë aty." Ky koment sugjeron se ka mungesë të njohurive se si të sigurojë përfshirje gjinore në të gjithë sektorët. Ndërrimi i shpeshtë i personave kontaktues për çështje gjinore brenda agjencive donatore mund edhe të ndikojë në njohuritë e tyre.

Në mënyrë që të adresohen këto sfida, donatorët duhet të konsiderojnë aktivitet e të drejtave të grave dhe organizatat si ekspertë që mund të asistojnë në përfshirjen e çështjeve gjinore. Sikurse AWID rekomandon, "Sikurse një kompani që angazhon

inxhinierët si ekspertë kur të investon në ndërtimin e një teknologjie të re, financuesit duhet të marrin ekspertë nga komuniteti i të drejtave të grave për të përkrahur përpiluar programet nga të cilat përfitojnë gratë dhe vajzat."[51]

Qasja e përfshirjes së çështjeve gjinore ngërthen edhe çështje tjera. Kur të përdoret si e vetme, e pashoqëruar nga ndonjë veprim tjetër që synojnë të shënjojnë shkaktarët e pabarazisë gjinore, mund të mos jetë e mjaftueshme për transformimin e normave gjinore. Përfshirja e çështjeve gjinore si e vetme jo domosdoshmërisht adreson pabarazitë gjinore dhe shkeljen e të drejtave të grave. Ndoshta, për të adresuar këto pabarazi kërkohen iniciativa specifike që prekin burimin e problemeve. Sikurse ka thënë një nga donatorët, ndonjëherë ka nevojë për iniciativa specifike për gratë të cilat adresojnë problemet që i hasin gratë.

"Disa çështje mund të mos adresohen përmes kësaj qasje." - Donator

Nga mbështetja e shoqërisë civile në ndihmë bilaterale?

Ndryshimet e fundit te disa donatorë drejt ndihmës bilaterale mund të kenë kontribuar në uljen e vlerës së financimit që është në dispozicion për OSHC-të. Pasi që Kosova ka ndërtuar institucionet e saja nga viti 2000 deri në vitin 2008, disa donatorë kanë hezituar të japin ndihma të drejtpërdrejta bilaterale. Në vend të kësaj, disa prej tyre kanë përfshirë shoqërinë civile për të shpërndarë ndihma humanitare dhe përkrahje për zhvillim. Disa kanë financuar drejtpërdrejtë programe drejt zhvillimit të kapaciteteve të shoqërisë civile. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, shumë donatorë kanë filluar të ndajnë ndihmë financiare, nganjëherë edhe vetëm, përmes institucioneve qeveritare. Në të vërtetë, *Deklarata e Parisit për Efektivitet të Ndihmave dhe Agjenda Akra për Veprim* inkurajojnë ndërlidhjen e ndihmës për zhvillim me strategjitë për zhvillim të shteteve partnere dhe dhënien e ndihmës përmes qeverisë.[52]

[51] AWID, 2013, faqe 24.
[52] OECD, *Deklarata e Parisit mbi Efektivitetin e Ndihmës dhe Agjenda Akra për Veprim,* 2005, 2008.

Tani, duke marrë parasysh aspiratat e Kosovës për t'iu bashkuar BE-së, donatorët janë duke ndarë ODA të theksuar përmes Ministrisë së Integrimeve Evropiane. Përveç mbikëqyrjes së ODA-s, kjo ministri është edhe partneri kryesor i BE-së në marrjen e vendimeve se si Kosova do të përdor fondet për zhvillim të BE-së. Duke konsideruar vlerën e konsiderueshme të fondeve të BE-së për Kosovën, kjo ministri ndikon në atë se cilat çështje i vendos BE si prioritet (p.sh. drejt barazisë gjinore dhe të drejtave të grave apo çështjeve tjera).

Sa i përket Deklaratës së Parisit dhe Agjendës Akra për Veprim, ministria dhe BE-ja duhet të përfshijnë edhe Parlamentin dhe shoqërinë civile, duke përfshirë organizatat e të drejtave të grave, në identifikimin e prioriteteve për zhvillim.[53] Organizatat për të drejtat e grave duhet të sigurohen se ministria dhe EU do të marrin parasysh prioritetet e grave në zgjedhjen e prioriteteve të financimit. Grupet e grave duhet të veprojnë bashkërisht më shumë me ministrinë. BE dhe donatorët tjerë duhet po ashtu të inkurajojnë ministrinë që të konsultohet me grupet e të drejtave të grave në përcaktimin e prioriteteve për zhvillim, sikurse është paraqitur në Deklaratën e Parisit.

Në këtë klimë të re të financimit, organizatat e të drejtave të grave mund të bashkëpunojnë më shumë me institucionet shtetërore, duke ofruar ekspertizë si dhe shërbime të cilat do të përmbushnin zbrazëtitë e shërbimeve shtetërore. Në të vërtetë disa donatorë kanë inkurajuar OSHC-të që të diversifikojnë burimet e tyre përmes ofrimit të shërbimeve. Megjithatë, donatorët e tjerë kanë frikë se financimi i OSHC-ve mund të inkurajoj ato të ofrojnë shërbime të cilat duhet të ofrohen nga shteti. "Disa OJQ rrezikojnë të zëvendësojnë atë çfarë duhet bërë nga institucionet," tha njëri.

Ndoshta donatorët mund të ofrojnë financim përmes qeverisë, duke inkurajuar qeveritë që të kontraktojnë OSHC-të për të kryer shërbime të cilat nuk mundet t'i ofroj, shtoj personi që u përgjigj. Për shembull, strehimoret pranojnë financim nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për t'i ndihmuar gratë dhe fëmijët të cilët vuajnë prej dhunës në familje. Ministria e Edukimit, Shkencës, dhe

[53] OECD, faqet 3 dhe 15.

Teknologjisë ka kontraktuar organizata të grave për të ofruar kurse për lexim dhe mësim për jetë për gratë në vende rurale. Shembuj të njëjtë pozitiv të bashkëpunimit ekzistojnë edhe në nivel komunal dhe në ministri tjera.

Megjithatë, vetëm 6% e të hyrave të organizatave të grave kanë ardhur nga qeveria. Qeveria e Kosovës ka mungesë të ekspertizës, mekanizmave, dhe përvojës në ndarjen e fondeve në mënyrë të duhur për OSHC-të, kanë thënë disa aktivist të drejtave të grave. Raportimet për klientelizëm ekzistojnë po ashtu. Një aktivist ka komentuar:

> Donatorët e mëdhenj mbështesin financiarisht vetëm qeverinë. Megjithatë, donatorët nuk mund të alokojnë fonde përmes qeverisë për shkak se qeveria jonë nuk e përkrah shoqërinë civile. ... Kur një shtet të ketë mekanizmat për barazi gjinore, nuk do të thotë se puna ka përfunduar; është me rëndësi që të zbatohen këto mekanizma.

Organizatat e të drejtave të grave janë shprehur të shqetësuara për shkak se rrallë mund t'i qasen trupave qeveritare për përkrahje financiare për avokim. Pranimi i financimit nga shteti mund të minoj pavarësinë e tyre, posaçërisht të organizatave watch-dog: nëse ato pranojnë fonde nga shteti, a munden ato "të kafshojnë orën që i ushqen ato," nëse është e nevojshme?[54] Varësia në resurse shtetërore mundet të minojë aftësinë e tyre për të evokuar, posaçërisht kur të kërkohet të mbajnë zyrtarët qeveritar përgjegjës.

Avokimi gjithashtu kërkon resurse afat-gjate dhe mbështetje institucionale, të cilën vetëm pak donatorë mund të ofrojnë. Një donator ka shpjeguar:

[54] Kjo çështje është diskutuar në prezantimin e Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, *Studimi gjinor në Kosovë* (2012) dhe në takimin dy mujor të RrGGK-së që ka pasuar, Prishtinë, 7 qershor 2013. Brenda këtyre diskutimeve, organizatat e grave kanë vënë në pah rëndësinë e diversifikimit të financimit të tyre dhe sigurimit se asnjë donator, përfshirë këtu shteti, nuk do të mbuloj më shumë se një të tretat e kostove të tyre.

> [Ne] kemi kufizime sa i përket shpagimit të OSHC-ve. Ne punojmë me qeveritë. ... Në ndërkohë, ne besojmë se nuk mundemi që të hapim rrugë për ndryshim të çështjeve gjinore nëse OSHC-të nuk janë aty për të vendosur këtë çështje në agjendë. [Ne] nuk mund të financojmë OJQ-të përderisa ato nuk punojnë drejtpërdrejtë për ne, por ne i ofrojmë përkrahje në një mënyrë tjetër. Ne jemi në pozitë të mirë për të hapur dialogun edhe me qeverinë për çështjet, prandaj mund të sjellim OSHC-të në biseda. ... Ne shohim veten tonë duke kontribuar në rolin e organizatave të grave, por jo vetëm duke i financuar ato.

Me donatorët të cilët shumë e më shumë po marrin të njëjtën qasje, pyetja është: kush i financon organizatat te grave ashtu që ato të mund të përballojnë të "vendosin çështjen në agjendë"? Nëse OSHC-të nuk mund të sigurojnë pagat apo fondet për prioritetet e tyre, ato nuk mund të kenë resurse të mjaftueshme njerëzore për të marrë pjesë në konsultimet. Shumica e akterëve hipotetikisht dëshirojnë të përfshijnë OSHC-të, por kush do e paguajë faturën?

Ndihma ndërkombëtare është qenësore ashtu që organizatat për të drejtat e grave të vazhdojnë pjesëmarrjen në procese vendim-marrëse, duke i mbajtur zyrtarët llogaridhënës, dhe duke shtyrë përpara zbatimin e ligjeve dhe legjislacionin. Me të vërtetë Agjenda Akra për Veprim inkurajon donatorët të përkrahin OSHC-të si "akterë të pavarur për zhvillim në të drejtën e tyre, përpjekjet e të cilëve plotësojnë ato të qeverive." Disa donatorë dhe aktivistë të drejtave të grave bëjnë thirrje për një qasje multi-sektorale që përfshinë financimin e qeverisë dhe angazhimin e shoqërisë civile për të mbajtur qeverinë llogaridhënëse.

Ndryshimi i kontekstit politik në Kosovë

Ndryshimi i kontekstit politik në Kosovë që nga deklarimi i pavarësisë në vitin 2008, ndoshta ka ndikuar në trendët e financimit në disa mënyra. Së pari, negociatat mes Kosovës dhe Serbisë, përfshirë këtu marrëveshjen politike të vitit 2013 mbi normalizimin e marrëdhënieve, kanë kontribuar tek disa vendime të donatorëve për të rritur ndihmën për veriun e Kosovës, duke përfshirë organizatat e grave që veprojnë atje. Për shembull, një donator raporton se ka shpërndarë më shumë se €580,000 për grupe të grave në pjesën veriore të Mitrovicës në vitin 2011, duke krahasuar me €0 në vitin 2008.

"Duket se gjithkush është duke vrapuar që të vendos flamurin kombëtar të tyre në Veri. Serbët ende jetojnë në Jug dhe kanë nevojë për ndihmë, por Veriu është atraktiv tani për tani. Për shumicën e donatorëve, megjithatë, nuk është çështja tek njerëzit që ndikohen, por si duket organizata e tyre." - Donator

Së dyti, konteksti politik relativisht stabil në Kosovë ka shtyrë disa donatorë të fokusojnë financimin në konflikte dhe kriza tjetërkund në botë. Një donator shpjegon:

> Kosova duke hyrë në procesin e Anëtarësimit në BE, nuk është prioritet për ne, pasi që ka vende tjera ku jemi më të nevojshëm. Mandati ynë rishikohet në baza mujore. Hipotetikisht, mund të kërkohet nga ne që të mbyllim zyren muajin e ardhshëm.[55]

Shpesh kuptimi i ngushtë i sigurisë që përdoret në Kosovë (si kombëtar dhe jo siguri njerëzore) injoron kërcënimet e sigurisë të cilat i hasin shumë mbrojtës të të drejtave të grave (p.sh., ekstremizmi fetar). Në ndërkohë, mandatet afat-shkurtra të donatorëve e bëjnë të vështirë planifikimin afat-gjatë dhe rrjedhimisht financimin afat-gjatë të organizatave të drejtave të grave. Pak donatorë kanë plane afat-gjate për Kosovën. Një donator ka komentuar:

[55] Emrat janë hequr për shkak të konfidencialitetit.

Pasi që Kosova tanimë ka qasje në fonde të BE-së, disa donatorë nuk e ndjejnë se ata duhet të japin resurse substanciale për Kosovën. Megjithatë, llojet e financimit të BE-së janë të kufizuara, duke synuar organizata më të fuqishme në Prishtinë me agjenda në përputhje me BE-në. Organizatat për avokim që kritikojnë politika të caktuara të BE-së dhe disa organizata grass-root që kanë mungesë të njohurive të avancuara të shkrimit anglisht nuk mund të kenë qasje në këto fonde.

"Çfarë shohim ne në Ballkan është se fondet janë duke u tkurrur shumë shpejtë. Faza emergjente ka kaluar, dhe pak organizata që kanë përkrahur organizatat e grave kanë mbetur këtu. Ky mund të jetë një problem i madh." – Donator

> Ka mungesë të interesimit për të investuar në këtë rajon. Ne nuk marrim fonde të pakufizuara deri në masën kur ne kemi nevojë për to në Evropë. Unë luftoj brenda me kolegët çdo ditë: "Ku duhet të punojmë ne? Në Afrikë, Amerikë Jugore, Lindje të Mesme …" Evropa është gjithmonë e fundit në listë, dhe kur ata përmendin shtete specifike, shumë rrallë përmendet Bullgaria apo Kosova. … Ata thonë, "Ne do të kemi strategji të ndarë për Evropën." Asnjë strategji e ndarë për rajonet tjera nuk ekziston. Është një lloj arsyetimi se Evropa do të kujdeset disi për vetën e saj. Megjithatë, unë shoh një trend fatkeq dhe të vazhdueshëm të rritjes së presionit ndaj përshtatjes dhe kreativitetit të OJQ-ve në Evropë.

Privatizimi i ndihmës? Grante vs. Kontrata

Kosova ka parë një ndryshim të mekanizmave të financimit nga grante në kontrata. Shumica e politikave dhe procedurave të donatorëve tanimë përfshijnë prokurimin. Njëri shpjegon:

> Ne mund të ofrojmë mbështetje për zbatim të drejtpërdrejtë të aktiviteteve, por kjo është një vlerë shumë e vogël. Sipas procedurave të brendshme të prokurimit, kontratat e mëdha duhet të shkojnë përmes prokurimit.

Organizatat e grave që punojnë në nivel lokal dhe nuk flasin anglisht nuk janë të pozicionuara për të konkurruar për kontrata. Për më tepër, ato duhet të garojnë për fonde kundrejt organizatave tjera dhe sektorit privat. Përderisa ftesat për aplikime mund të theksojnë rëndësinë e përfshirjes gjinore, shumë rrallë donatorët kanë veprime afirmative për të inkurajuar organizatat e të drejtave të grave të aplikojnë.

"Ne kontraktojmë partnerët për të kryer punët. Ne nuk japim fonde specifike për organizatat e grave por ne japim fonde për organizatat që fokusohen në çështje." – Donator

Aktivistët e të drejtave të grave kanë kritikuar këto procese për "privatizimin" e ndihmës për zhvillim. Në disa raste donatorët kanë përdorur "modelin e sektorit privat" për të financuar kompani profitabile sesa organizata për të drejta të grave të cilat janë më efikase, efektive, dhe më me përvojë, tha ai. Një aktivist thotë:

> Edhe agjencitë e OKB-së flasin me krenari për zbatimin e UNSCR 1325, ku Rezoluta thekson se OJQ-të e grave duhet të përkrahen, agjencitë e OKB-së e bëjnë kryesisht të kundërtën. Ato i zvogëlojnë mundësitë përmes të cilave OJQ-të e grave mund të përkrahen. Procesi i aplikimit përfshinë konkurencën në mes të OJQ-ve të grave dhe kompanive private, por ne jemi aktiviste të drejtave të grave dhe jo kontraktorë!

Në vend se të përkrahen organizatat e të drejtave të grave për të realizuar misionet dhe strategjitë e tyre, ushtrimet përmes ofertave nxisin konkurencën në mesin e organizatave të grave dhe i japin resurse kompanive të cilat mund të shkruajnë propozime të mira por jo domosdoshmërish kanë ekspertizën e nevojshme për të avancuar barazinë gjinore dhe të drejtat e grave, thotë një aktivist. Përveç kontratave donatorët duhet të kenë fonde të mjaftueshme të mbështesin grupet e grave dhe strategjitë e tyre afat gjate.

"Fondacionet gjithnjë e më shumë po i trajtojnë OJQ-të … jo si inovatorë, por si kontraktues, të cilët janë angazhuar të ofrojnë vizione të donatorëve se çka duhet bërë." – AWID

"Ujitja e gjetheve, tharja e rrënjëve"

Qasja e "sektorit privat" për financim të shoqërisë civile është një ilustrim i trendëve më të gjëra drejt "menaxhimit për rezultate". Trendet e financimit të projekteve me outpute afat-shkurtra.[56] AWID ka vëzhguar:

> Elemente thelbësore të luftës për një qëndrueshmëri afat-gjate për të transformuar institucionet dhe strukturat të cilat jetësojnë diskriminimin gjinor dhe te format tjera të diskriminimit dhe përjashtimit konsiderohen shumë të ngadalshme dhe vështirë për t'u matur, dhe marrin pak apo nuk marrin fare përkrahje, përveç përkrahjes nga një grusht i donatorëve me njohuri të theksuara dhe me përvojë.[57]

Rezultati, sikurse që është përmbledhur në titullin e raportit të ri të AWID-it, është "ujitja e gjetheve, tharja e rrënjëve." Kjo i bie, donatorët ofrojnë resurse për iniciativa për barazi gjinore dhe të drejta të grave, por nuk financojnë në mënyrë adekuate kostot bazë që OSHC-të kanë nevojë për pohimin e ndryshimeve transformative.[58] Organizatat për të drejtat e grave kanë nevojë për mbështetje të vazhdueshme në mënyrë që të realizojnë vizionin e tyre afat gjatë, dhe të sjellin ndryshime në shoqëri.

"Në mënyrë që të zbatohet një projekt, duhet të kenë zyre." – Donator

Në Kosovë pak donatorë ofrojnë përkrahje afatgjate, institucionale apo bazë për organizatat. Ata lejojnë disa kosto mbi shpenzimet tjera, aq gjatë sa kostot kontribuojnë në zbatimin e projektit. Shumë donatorë kufizojnë kostot jo të drejtpërdrejta. Njëri prej tyre shpjegon:

> Është politikë e jona, posaçërisht nëse bashkëpunimi vazhdon për disa vjet, që të mundohemi që të mos financojmë kosto indirekte. Ne i inkurajojmë OSHC-të që të mos kenë kosto indirekte apo më pak kosto të tilla çdo vit. Ne dëshirojmë të

[56] AWID, 2013.
[57] AWID, 2013, faqe 10.
[58] AWID, 2013, faqe 17.

> sigurohemi se intervenimet tona janë të qëndrueshme dhe se OSHC-të nuk bëhen të varura. Megjithatë, ne dëshirojmë që partnerët tanë të avokojnë, prandaj është e vështirë. ... Gjithmonë është rreziku i varësisë në fonde të donatorëve, por OSHC-të janë pjesë shumë e rëndësishme e shoqërisë. Donatorët duhet të marrin parasysh se si t'i përfshijnë ato.

Financim i kufizuar rrallë lejon financim për kosto bazike apo fleksibile në të cilat organizata për të drejtat e grave do të bazoheshin për të ndërmarrë iniciativa strategjike. Në vitin 2010, vetëm 18% e organizatave të grave kanë raportuar të kenë pranuar mbështetje bazë, e cila llogaritet si 24% e të hyrave të përgjithshme të tyre, mesatarisht. Megjithatë, 76% e organizatave kurrë nuk kanë pranuar mbështetje bazë.[59]

"Donatorët nuk paguajnë më për paga, por vetëm për aktivitete." – OSHC

Disa donatorë kanë shprehur shqetësimin se zvogëlimi i financimit të tyre bazë mund të ndikojë në punën e tyre në Kosovë në të ardhmen. Ata vënë në pah kostot për personel dhe operacione si "vështirë për t'u matur". Për ironi, organizatat e grave hasin sfida të ngjashme në arsyetimin e kostove të tyre të personelit dhe operimit. Ndoshta mundësitë ekzistojnë këtu për të identifikuar strategji të përbashkëta për mobilizim të resurseve.

"Nëse OSHC-të janë më transparent se si i përdorin fondet, donatorët mund të kenë vullnet për të përkrahur." – Donator

Përderisa pak donatorë kanë thënë se do të merrnin parasysh dhënjen e mbështetjes bazë për organizatat e grave në të ardhmen, të tjerët kanë thënë se politikat e tyre e bëjnë të pamundur: "Mbështetja [e jonë] gjithmonë do të jetë e bazuar në projekt për shkak të politikave [tona] të prokurimit. Në qoftë se është ndonjë projekt i mirë, [ne] mund të ofrojmë mbështetje, por për projekte dhe jo për mbështetje bazë." Donatorët që kanë vullnet për të marrë parasysh ofrimin e mbështetjes bazë kanë thënë se ata kanë nevojë për transparencë më të madhe të organizatave, resurse të mjaftueshme për të dhënë

[59] Në krahasim, në studimin global të AWID për vitin 2012, 48% e organizatave nuk kanë pranuar kurrë financim bazë.

financim të tillë, dhe/apo partnerët e tyre do të duhej të vendosnin prioritetet e financimit për kosto bazike. Organizatat e grave kanë nevojë që të "ndërtojnë rastin" për mbështetje bazë, thotë një donator. Ato kanë nevojë që t'iu qasen donatorëve dhe të ngrisin zërin e tyre sa i përket prioriteteve dhe nevojave.

Disa donatorë kanë thënë se nuk kanë resurse njerëzore të brendshme të mjaftueshme për të ofruar mbështetje bazë, posaçërisht për organizata të vogla. Ata do të duhej të kontraktonin apo të hynin në partneritet me ndonjë organizatë tjetër që është e aftë për të dhënë grante.

Në mënyrë që të adresohen sfidat me resurse njerëzore të cilat hasen nga donatorët dhe të përfshihen grupet grass-root që nuk kanë qasje në fondet tjera, RRGGK ka krijuar Fondin për Gratë e Kosovës, i cili kombinon grante të vogla me trajnim intensiv dhe mentorim për organizata të vogla. Fondi shpesh mbështet grupe të margjinalizuara të grave në realizimin e prioriteteve të tyre strategjike duke iu ofruar atyre aftësi konkrete që ato mund t'i përdorin për të siguruar fonde shtesë në të ardhmen. "Fondi për Gratë e Kosovës i jep organizatave grass-root mundësinë për të qenë më aktiv dhe të fokusohen në çështjet që janë të rëndësishme për gratë," ka komentuar një nga përfituesit. Fondi ka treguar rezultate fillestare premtuese në aspektin e avokimit grass-root dhe avancimin e kapaciteteve organizative. Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar përmes Kvinna till Kvinna ka përkrahur Fondin, i cili më vonë ka gëzuar përkrahje shtesë edhe nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA). Fondi ka mundësuar ADA-s që të përkrahë grupet grass-root që nuk do të kishte ndryshe resurse njerëzore për të financuar. Fondi për Gratë e Kosovës ofron zgjidhje potenciale për donatorët e tjerë të cilët dëshirojnë të përkrahin grupe rurale dhe të margjinalizuara (financiarisht dhe në ndërtim të kapaciteteve të tyre) pa shkresa të cilat i përcjellin menaxhimin e një mori projekteve të vogla.

"Donatorët duhet të bashkëpunojnë më shumë, si një ombrellë e organizatave për të drejta të grave, ashtu që organizatat e grave mund të fuqizohen më shumë." – OSHC

Një çështje e ndërlidhur ngushtë, kontratat shumë vjeçare mund t'iu mundësojnë organizatave për të zbatuar strategji drejt një vizioni afat gjatë. Donatorët që kanë ofruar mbështetje të vazhdueshme për organizatat e njëjta për disa vjet kanë thënë se mund të shohin ndryshimin në forcimin e sistemit të këtyre organizatave, ngritje të fondeve, dhe kapaciteteve. Për to, përkrahja afat-gjate qartazi e bën diferencën në forcimin e lëvizjes së grave në Kosovë dhe avancimin e ndryshimeve shoqërore.

"Financimi për strategjitë e organizatave duhet të jetë minimum tre vjeçar. Donatorët me përjashtim të BE-së nuk ofrojnë financim për më shumë se një vit, dhe ne nuk jemi në gjendje të zbatojmë plotësisht strategjinë tonë." – OSHC

Në përfundim, duke marr parasysh kontekstin në të cilin gjendet Kosova dhe sfidat me të cilat organizatat për të drejtat e grave ballafaqohen, hapësira që është e nevojshme për të qenë proaktiv dhe për të diskutuar çështjet të cilat iu duhen zgjidhje, organizatat e grave duhet të vazhdojnë punën e tyre në ngritjen e vetëdijes. Organizatat për të Drejtat e Grave duhet gjithashtu të punojnë më komunitetin e donatorëve dhe t'u tregojnë atyre për rëndësinë që këto organizata luajnë në adresimin e pabarazive shoqërore dhe gjinore. Donatorët dhe organizatat e të drejtave të grave mund të diskutojnë së bashku për zgjidhje të mundshme, duke përfshirë këtu edhe indikatorët dhe njësinë matëse e cila është e shkurtër derisa indikatorët janë të definuar ashtu që nuk mund të maten për një kohë të shkurtër kohore, sidomos kur flasim për ndryshim të vlerave dhe normave gjinore; që do të thotë financim afatgjatë dhe rezultate afatgjate, duke krijuar kështu mundësi për vazhdimin e punës së organizatave të cilat kontribuojnë vazhdimisht në transformim dhe ndryshim të këtyre normave drejt arritjes së barazisë gjinore dhe të drejtave të grave.

Bibliografia

American Bar Association Central dhe Eastern European Law Initiative dhe American Association for the Advancement of Science, "Vrasjet politike në Kosova/Kosovo," mars– qershor 1999, në: http://shr.aaas.org/kosovo/pk/p1_2.html.

Arutyunova, Angelika dhe Cindy Clark të Asociacionit për të Drejtat e Grave në Zhvillim (AWID), *Ujitja e gjetheve, Tharja e Rrënjëve: Status i Financimit të Organizatave për të Drejtat e Grave dhe Barazia Gjinore,* Toronto: AWID, 2013.

Batliwala, S. *Duke Ndryshuar Botën: Konceptet dhe Praktikat e Lëvizjes së Grave*, AWID, 2008. në: http://www.awid.org/Library/Changing-their-World-Concepts-and-practices-of-women-s-movements-2nd-Edition.

Qendra për Studime Gjinore (QTSGJ), *Historia është Tregimi i saj, Gjithashtu*, Prishtina: KGSC, 2008.

RrGGK, *Hulumtimi kërkimor mbi nivelin e dhunës ne baza gjinore në Kosovë dhe ndikimi në shëndetin riprodhues të grave,* Prishtinë: RrGGK, 2008.

Agjencia e Statistikave të Kosovës, website: http://esk.rks-gov.net/

Ministria e Financave, *Raporti mbi aktivitetin e donatorëve në Kosovë 2005,* Prishtinë: 2006.

Ministria e Integrimeve Evropiane, *Raporti për ODA: Partnerët zhvillimor për AMP sipas sektorëve*, Prishtinë: 2012.

Ministria e Integrimeve Evropiane, *Raporti i aktiviteteve të donatorëve në Kosovë 2009*, Prishtinë: 2009.

Komisionin e Organizatës për (OECD) Ndihmë në Zhvillim "Principet për Vlerësim dhe Ndihmë në Zhvillim", Paris: OECD, 1991, në: http://www.oecd.org/dac/evaluation/50584880.pdf, dhe "DAC Kriteret për vlerësimin e Ndihmës për Zhvillim," në: http://www.oecd.org/dac/evaluation/daccriteriaforevaluatingdevelopmentassistance.htm.

_____. OECD, *Deklarata e Parisit mbi Efektivitetin e Ndihmës dhe Agjenda Akra për Veprim,* 2005, 2008.

_____. *Të gjeturat nga Moduli për Barazi Gjinore i vitit 2011 Pyetësori për Monitorimin e Deklaratës së Parisit.* OECD. në:

http://www.oecd.org/dac/gender-development/49014760.pdf.

_____. *Parimet e Vlerësimit të Asistencës Zhvillimore*. Paris: OECD, 1991. në: http://www.oecd.org/dac/evaluation/50584880.pdf.

Agjencia e Statistikave të Kosovës. Popullësia e Kosovës. Prishtina: ASK, 2003. në: http://www.ks-gov.net/esk/esk/pdf/english/population/Kosovo_population.pdf.

Komiteti për Refugjatë dhe Imigrantë në SHBA, "World Refugee Survey 2000: Jugosllavia. në: http://www.refugees.org/countryreports.aspx?__VIEWSTATE=dDwxMTA1OTA4MTYwOztsPENvdW50cnlERDpHb0J1dHRvbjs%2BPrImhOOqDI29eBMz8b04PTi8xjW2&cid=443&subm=19&ssm=29&map=&_ctl0%3ASearchInput=+KEYWORD+SEARCH&CountryDD%3ALocationList.

Rezoluta e Këshillit të Sigurisë e Kombeve të Bashkuara. *Rezoluta 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.* 2000.

Komisioni Evropian. "Komunikimi nga Komisioni i Parlamentit Evropian, Këshilli, Komiteti për Cështje Ekonomike dhe Sociale, dhe Komiteti Rajonal: Rrënjët e demokracisë dhe zhvillimi i qëndrueshëm: Angazhimi i Evropës me shoqërinë civile." Bruksel: Komisioni Evropian, 2012. në: http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2012:0492:FIN:EN:PDF.

Shtojcat

Shtojca 1. Fragment nga AWID

Fragment nga Lydia Alpizar, Drejtore Ekzekutive, nga AWID, 2013

Çelësi për të kuptuar analizat dhe rekomandimet e AWID në këto raporte janë supozimet dhe besimet që ne i mbajmë, jo vetëm lidhjen në mes të të drejtave të grave dhe resurseve, por gjithashtu çfarë përbën dhe prodhon kushte për avancim të të drejtave të grave dhe barazi gjinore. Këto janë të bazuara në njohuritë dhe mësimet që kanë dalë nga puna me përkushtim dhe inovative e aktivistëve dhe lëvizjeve të të drejtave të grave përgjatë gjysmës së shekullit të kaluar në mbarë botën. Këto nuk janë pozicione të ngurta, të pandryshuara apo perceptime të njëjta dhe të përgjithshme – pasi që si organizatë ndërkombëtare, me anëtarë institucionalë dhe individualë nga 150 vende, ne jemi të vetëdijshëm se dinamikat dhe manifestimet e pabarazisë gjinore, dhe ndërlidhja me një varg të strukturave të pushtetit (bazuar në faktor të identitetit, fuqisë ekonomike, lokacionit, dhe historik), janë shumë kontekstuale. Në vazhdim janë tetë propozimet bazë për informim të analizave që t'u japin formë këtyre serive të raporteve hulumtuese:

Propozimi ynë i parë është që strukturat e pushtetit gjinor – dhe nën-strukturat – transformohen më së miri përmes intervenimeve në katër fusha kyçe:

i. Besimet dhe qëndrimet e brendshme të burrave dhe grave – atë çfarë feministët e quajnë "ndërgjegje" – ku proceset e socializimit nga fëmijëria e hershme iu japin grave dhe burrave besime të caktuara rreth rolit të tyre në shoqëri, pushtetit të tyre – apo pafuqisë – dhe gjithashtu të drejtat, privilegjet dhe përgjegjësitë e tyre.

ii. Normat shoqërore dhe kulturore që mbështesin dhe "i bëjnë normale" dallimet gjinore sa i përket qasjes në resurse, fuqi, privilegje, mundësi, dhe përgjegjësi. Këto norma mësohen hapur

në institucione sikurse familja, klani, apo fisi, apo feja, por më të përforcuara në shkollë, vend të punës, apo hapësira të tjera ku rregullat zyrtare mund të avokojnë për barazi gjinore, por praktikat jo zyrtare përforcojnë dallimet gjinore.

iii. Ligjet, politikat, strukturat dhe ndarja e resurseve në formë zyrtare të cilat vijnë përmes qeverive, makinerisë së zbatimit të ligjit, dhe institucioneve shumëpalëshe rajonale dhe botërore, ku paragjykimet gjinore shpesh janë ngulitur, apo prapë, praktikohen jo zyrtarisht.

iv. Qasja në resurse të materialeve dhe njohurive, dhe po ashtu në të drejtat dhe mundësitë – këtu përfshihen jo vetëm resurset sikurse toka apo punësimi apo kredia, por gjithashtu edukimi, kujdesi shëndetësor, të drejtat e trashëgimisë, mundësitë e trajnimit, e drejta për të qenë në hapësira ku agjendat për zhvillim dhe buxhete formësohen, dhe kështu me radhë.

Ne nuk besojmë se pozita e grave në shoqëri do të ndryshojë thjeshtë duke vepruar në një sferë – duke rritur të drejtat e tyre në formë zyrtare përmes ligjit, apo duke rritur qasjen e tyre në resurse dhe të ardhura, apo duke ndryshuar normat shoqërore përderisa besimet e brendshme dhe ligjet zyrtare dhe politikat mbesin të pandryshuara. Intervenimet drejt barazisë gjinore dhe të drejtave të grave duhet të adresojnë të gjitha këto sfera të pushtetit gjinor.

Propozimi ynë i dytë është që ndryshimi i thellë dhe i qëndrueshëm për të drejtat e grave kërkon veprimin dhe fuqinë kolektiv të grave. Qasjet e shtyra nga "ofrimi", sikurse që është fuqizimi individual i grave me punësim, edukim, kredi, apo qasja në pozita politike nuk mund të arrijë ndryshim sistematik dhe në shumë fusha, megjithëse mund të përmirësonte kualitetin e jetës individuale të grave apo zërin e tyre në çështje publike. Ndryshimi i qëndrueshëm në pushtetin gjinor mund të arrihet vetëm përmes qasjeve të shtyra nga "kërkesa", duke mobilizuar gratë, duke ndërtuar vetëdijen e tyre rreth fuqive dhe mundësive për ndryshim, dhe duke mobilizuar fuqitë kolektive për të udhëhequr dhe vepruar së bashku për vizionin e tyre për një rend

shoqëror më të drejtë. Me fjalë të tjera, ne besojmë – dhe me të vërtet, jemi dëshmitarë – që duke ndërtuar lëvizje të grave, me vetëdije të fortë rreth rrënjëve të padrejtësisë, të strukturave të pushteteve shoqërore dhe gjinore dhe të mekanizmave që mbështesin dhe i riprodhojnë ato, ato do të punojnë së bashku për të synuar transformim shoqëror të gjerë, të thellë, dhe më të qëndrueshëm. Në esencë, kjo është ajo çfarë ne kuptojmë kur përdorim termin "organizimi i të drejtave të grave" apo "qasja për të drejta të grave", që të bëjmë dallimin e saj nga qasjet instrumentale të shtyra nga "oferta".

Propozimi ynë i tretë është që ndryshimi transformues i vërtetë në jetën e grave do të rezultojë nga dhënia e qasjes në trupat e plotë të të drejtave të njeriut sikurse që është paraparë në instrumente dhe marrëveshje ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ne nuk besojmë se qasja në një grup të të drejtave – sic është barazia ekonomike – do të garantojë apo domosdoshmërisht do të qojë drejt rritjes së qasjes në të drejtat e tjera. Ne synojmë një botë ku plotësimet e plota të të drejtave – civile dhe politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore – do të jetësohen dhe përjetohen në realitet, jo normat e largëta apo idealet e paarritshme. Ky është versioni ynë i qëllimit përfundimtar i ndërtimit të fuqisë kolektive të grave, dhe i botës më të mirë që mund të ngritet si rezultat i mbështetjes së organizimit të të drejtave të grave.

Propozimi ynë i katërt është që të drejtat e grave dhe barazia gjinore nuk mund të lihet apo të sillet nga forcat e tregut – në të vërtetë, nuk ka asnjë dëshmi që ato munden, qoftë edhe në vendet ku politikat neo-liberale kanë qenë për dekada, dhe gratë janë bërë edhe pjesë kryesore e fuqisë punëtore zyrtare apo segment i rëndësishëm i tregut. Sigurimi i të drejtave të grave në avancimin e barazisë gjinore duhet të vazhdoj të jetë shqetësim prioritar dhe përkushtim i akterëve shtetëror, dhe i trupave shumëpalësh në nivel ndërkombëtar. Shtetet ekzistojnë për shkak të qytetarëve të tyre, dhe se mbrojtja e të drejtave të qytetarëve është përgjegjësi primare e shtetit. Kur gjysma e qytetarëve të tyre, përgjithësisht, janë të privuar nga barazia në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike, apo vazhdojnë të jenë

objektiv i dhunës në baza gjinore, shtetet janë bartës primar të detyrës për të mbrojtur të drejtat e grave dhe ndjekjen e atyre të cilët mohojnë apo shkelin të drejtat e tyre. Kështu, shtetet dhe institucionet shumëpalësh duhet të vazhdojnë të jenë objektivat kyçë për avokimin tonë, dhe do të mbahen llogaridhënës për të dhënat e tyre në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave qytetareve të grave.

Propozimi ynë i pestë është që edhe pse shtetet dhe akterët shumëpalësh mbajnë përgjegjësi primare për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave he barazinë gjinore, roli i akterëve të rinjë në zhvillim – posaçërisht i sektorit privat – në formësimin dhe ndikimin në qasjen e grave në të drejtat e tyre, apo shkelja e këtyre të drejtave. Prandaj, ne besojmë se përfshirja me këta akterë të rinjë nga organizatat dhe lëvizjet e të drejtave të grave është një strategji esenciale, por në një mënyrë kritike dhe të konsiderueshme, që nuk rezulton qoftë në kundërshtim të opsionit të përbashkët, apo të njëtrajtshëm. Ne kemi nevojë që të edukojmë veten tonë rreth realiteteve të reja dhe vargun e akterëve të përfshirë në proceset zhvillimore, posaçërisht ato të cilat ndikojnë thellë tek gratë, të analizojmë ndikimet gjinore të tyre, dhe të marrim pozicione të informuara që përfshijnë përfshirje kritike për të ndikuar në këto procese në mënyra që mund të avanconin agjendën tonë afat-gjate.

Propozimi ynë i gjashtë është që frutat e ndryshimit transformues nuk mund të merren si të garantuar, por duhet të mbrohen, ruhen, dhe të jenë të qëndrueshme. Përvoja tregon se edhe fitoret e të drejtave të grave që janë fituar dekada më parë janë nën kërcënim për t'u kthyer prapa – sikurse që është zgjedhja për riprodhim, qasja në edukim themelor, liria e lëvizjes. Përplasja ndaj avancimeve të grave nuk është ngritur vetëm nga tradicionalistët, por nga burimet e reja sikurse rrjetet kriminale dhe terroristët që ngatërrojnë fenë. Organizimi i të drejtave të grave dhe lëvizjet e fuqishme të grave janë mburojë thelbësore kundër këtyre forcave, dhe se shpesh forca e vetme që lufton për të mbrojtur fitoret e të kaluarës.

Propozimi ynë i shtatë është që këto lloje të proceseve ndryshuese kolektive për transformim shoqëror afat-gjatë në favor të barazisë

gjinore nuk mund të ndërtohen pa resurse, dhe prandaj shqetësimi ynë i thellë është me disponueshmërinë e resurseve për organizim të drejtave të grave dhe ndërtim të lëvizjes. Ne jemi të vetëdijshëm se shumica e lëvizjeve të suksesshme të grave në botë më së shumti kanë resurse vetanake dhe autonomi financiare – por organizatat që ndihmojnë ndërtimin e këtyre lëvizjeve nuk kanë! Të gjitha ato janë përkrahur nga donatorët, qeveritë, dhe filantropët, dhe kanë lejuar që të gjinden mënyrat më të mira për ndryshim. Përkrahja e iniciativa të tilla, në një botë ku pasuria gjithnjë e më shumë është duke u koncentruar, dhe dallimet në të ardhura janë duke u rritur, është një përgjegjësi më e gjerë shoqërore dhe një etikë e domosdoshme. Prandaj ne besojmë se të gjithë ata të cilët theksojnë se shqetësimi i tyre në avancimin e një bote më të drejtë, më të barabartë dhe më të qëndrueshme, posaçërisht e atyre të cilët tani për tani avokojnë "investimin në gra dhe vajza", kanë përgjegjësi për të ndarë burime për organizim të të drejtave të grave në mënyrë të duhur dhe me financim serioz. Ata kanë përgjegjësi që të investojnë në organizim të të drejtave të grave. Ne e sfidojmë mitin se kjo qasje nuk meriton mbështetje financiare serioze pasi që është shumë e ngadaltë – nëse ne konsiderojmë se sistemi patriarkal dhe institucionet e tij janë më shumë se dhjetë mijë vjet të vjetra, atëherë llojet e ndryshimeve që organizatat dhe lëvizjet e të drejtave të grave krijojnë në kohë prej pesë apo dhjetë vjetësh duhet të shihen si diçka që ndodh në shpejtësi të dritës!

Propozimi ynë i tetë dhe përfundimtar është që mobilizimi i resurseve për organizim të të drejtave të grave dhe lufta jonë afat-gjatë për barazi gjinore është një përgjegjësi kolektive. Nuk duhet të jetë plotësisht mbi vullnetin e organizatave dhe lëvizjeve për të drejta të grave, apo të lëvizjeve të tjera për drejtësi shoqërore, për të bindur të tjerët që të investojnë dhe të përkrahin punën e tyre. Është po ashtu përgjegjësi e shteteve, sektorit privat, dhe e akterëve tjerë nga komuniteti i donatorëve të cilët kanë dëshirë të avancojnë të drejtat e njeriut dhe drejtësinë shoqërore, të mësojnë se çfarë funksionon më së miri në krijimin e rezultateve të qëndrueshme, dhe të investojnë jo vetëm në projekte që kanë kthim të shpejtë, por gjithashtu në punë më të vështira por transformuese sa i përket rrënjëve të padrejtësive.

Ne besojmë se shtrembërimet e tanishme në qasje të resurseve për grupet e të drejtave të grave nuk është rezultati i neglizhencës me paramendim, paragjykim apo diskriminim, por është mungesë e informatave dhe të kuptuarit e çështjeve në fjalë. Ne besojmë se është roli ynë që të ndihmojmë në mbushjen e kësaj zbrazëtie, sic shihet nga ky raport dhe publikimet simotra shpresojnë të bëjnë. Ne besojmë se është përgjegjësi e jona të ndihmojmë nxitjen e bisedave më mirë të informuara në mes akterëve në fjalë, dhe shpresojmë se publikimet sikurse ky do të na ndihmojnë të gjithë ne që të vazhdojmë përpara në këtë drejtim.

Shtojca 2. Donatorët me fonde për Organizatat të Grave

Kjo shtojcë është menduar të shërbejë si informacion për organizatat e grave në Kosovë. Përfshin të gjitha organizatat të cilat ofrojnë fonde për organizatat e grave, dhe janë të renditura sipas alfabetit (në gjuhën angleze). Shumë donatorë, si p.sh. agjencionet e UN, përmes thirrjeve që bëjnë, kohë pas kohe ftojnë organizatat e grave të konkurojnë me projekte. Në kohën e publikimit të këtij raporti, nuk ka ndonjë thirrje të tillë, prandaj edhe nuk janë prezantuar në këtë raport.

Association for Women's Rights in Development (AWID)

AWID është organizatë ndërkombëtare me anëtarësi, feministe, që synon arritjen e barazisë gjinore, zhvillimit të qëndrueshem dhe organizatë e të drejtave të grave. AWID ofron grante të vogla për organizatat e grave. Për më shumë informacione vizitoni: http://www.awid.org/.

Austrian Development Agency (ADA)

Përvec financimit të RrGGK-së - Fondin për Gratë, që do të ketë tri raunde për organizatat e grave në vitin 2014 (vizitoni www.womensnetwork.org për më shumë informacione), ADA gjithashtu ofron grante te vogla, në shumën që arrin deri në €10,000 për projekt. Organizatat e interesuara mund të kontaktojn ADA për detajet.

Balkan Trust for Democracy (BTD)

BTD mbështet zhvillimin e demokracisë, qeverisjen e mirë dhe integrimet Euroatalantike nga viti 2003. Për më shumë informacione vizitoni: http://www.gmfus.org/grants-fellowships/grantmaking-programs/balkan-trust-for-democracy/.

British Embassy

Ambasada Britaneze në Kosovë punon në fushën e sundimit të ligjit, të drejtat e njeriut, zhvillimi ekonomik, siguria, dhe bashkëpunimi rajonal. Për më shumë informacione vizitoni:

https://www.gov.uk/government/world/kosovo.

Cfd The Feminist Peace Organization (CFD)

Cfd është organizatë feministe e cila punon në bashkëpunim ndërkombëtar, çështje të migrimit politik, dhe promovim të paqes. Cfd bashkëpunon me partnerët lokal në mënyrë konsistente dhe planifikon të financoj këto organizata edhe në të ardhmën. Cfd mund të rris numrin e partnereve vitin e ardhshëm varësisht nga fondet.

Danish Refugee Council (DRC)

DRC punon në me të kthyerit në Kosovë, në krijimin e procesit të qëndrueshëm dhe të përballueshëm për ta. Si pjesë e ndihmës që ofrojnë për Roma, Ashkali dhe Egjiptas, ata punojnë në zhdukjen e analfabetizmit tek gratë dhe të rinjët. Për më shumë info vizitoni: http://drc-kosovo.org/.

European Commission

Komisioni Evopian ka thirrje të hapura për SHC ku organizatat mund të aplikojnë, kryesisht përmes Instrumentit Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR), mirëpo kohë pas kohe përdor edhe instrumente tjera (p.sh., IPA). EIDHR ka për qëllim të "punoj me, për dhe përmes organizatave të shoqërisë civile" për të avancuar të drejtat e njeriut, dhe fuqizuar rolin e shoqërisë civile në promovimin e të drejtave të njeriut dhe reformën demokratike.[60] Thirrjet për aplikime shpallen disa herë gjatë vitit. Për më shumë informacione vizitoni: http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/grants_tenders/grants/index_en.htm.

Embassy of Finland

Ambasada Finlandeze shpall thirrjet për aplikime për organizatat e SHC, përshirë organizatat e grave. Thirrjet bëhen përmes ëebsite të tyre në: www.finlandkosovo.org.

Embassy of Norway

[60] Për më shume informacione vizitoni: http://ec.europa.eu/europeaid/hoë/finance/eidhr_en.htm.

Ambasada Norvegjeze përmes Fondit të Vogël ofron mbështetje për rininë, krijimin e mundësive për punësim, dhe fuqizimin e praktikave demokratike. Për më shumë informacione: http://www.norway-kosovo.no/Embassy/Development-Cooperaton/The-Embassy-Fund/About-the-Embassy-Fund/.

Embassy of the Kingdom of the Netherlands

Kjo ambasadë ofron mbështetje për organizatat të cilat kanë projekte deri në 12 muaj. Projektet duhet të jenë të ndërlidhura me legjislacionin, ligjin, qeverisjen e mirë, të drejtat e njeriut, (në veçanti minoritetet dhe të drejtat e grave) dhe mediat e lira dhe të pavarura. Për më shumë informacione vizitoni: http://kosovo.nlembassy.org/services/development-co-operation/development-co-operation.html.

Global Fund for Women (GFW)

GFW ofron grante deri në shumën $14,000. Shumica e granteve janë një vjeçare dhe mund të shfrytëzohen edhe për shpenzime operacionale. Organizatat mund të aplikojn online. GFW mbështet organizatat që kanë bashkëpunuar më herët, mirëpo mund të mbështesin edhe organizatat e reja nëse propozimet e tyre janë premtuese dhe kanë ndikim.

Kosovo Civil Society Foundation (KCSF)

KCSF ka për mision të fuqizoj iniciativat qytetare duke ofruar mbështetje, informacione, shërbime dhe trajnime për OJQ e SHC. KCSF ka menaxhuar projektin Society Promotion (DSP), të financuar nga Sëiss Cooperation Office Kosovo (SCO-K), që synon të mbështes zhvillimin e praktikave demokratike dhe zhvillimin e një shoqërie demokratike në Kosovë. Për më shumë informacione viziton: http://www.kcsfoundation.org/dsp/?page=2,1.

Kosovo Fund for Open Society (KFOS)

KFOS është organizatë lokale jo-qeveritare dhe pjesë e rrjetit të fondacionit filantropik të financuar nga George Soros. Fondacioni punon me qeverinë dhe organizatat joqeveritare të SHC në implementimin e politikave ekzistuese dhe zhvillimin e strategjive të

reja. KFOS ofron grante të vogla për SHC. Për më shumë informacione vizitoni: www.kfos.org.

Fondi i Grave – RrGGK

Financuar nga KtK dhe ADA, Fondi i Grave ofron grante të në shumë prej €3,000, me kohëzgjatje deri në gjashtë muaj apo një vit. Vetëm organizatat anëtare të Rrjetit që përmbushin kriteret mund të aplikojnë. Për më shumë informacione: http://www.womensnetwork.org/?FaqeID=33.

Mama Cash

Mama Cash ishte organizata e parë ndërkombëtare e grave në botë. Financojnë dhe mbështesin organizatat dhe iniciativat e grave në gjithë botës duke synuar të sfidojnë pabarazitë. Për më shumë informacione, vizitoni: www.mamacash.org.

Mott Foundation

Mott Foundation ofron grante përmes procesit të aplikimit. Për më shumë informacione vizitoni: www.mott.org.

Olaf Palme Centre (OPIC)

OPIC në Kosovë nuk ka thirrje të hapura për për SHC, mirëpo organizatat mund të i qasen Qendrës për bashkëpunim dhe iniciativa të përbashkëta. Për më shumë informacione mund të vizitoni: http://www.palmecenter.org/.

Rockefeller Brother Fund (RBF)

Themeluar në vitin 1940, (RBF) avancon ndryshimet në shoqëri duke kontribuar në drejtësi, qëndrueshmëri, dhe paqe nëpër botë. Skema e granteve të RBF ka këto tema: Praktikat demokratike, ndërtimi i paqes, dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Për më shumë informacione vizitoni: http://www.rbf.org/.

Swedish International Development Agency (SIDA) & Kvinna till Kvinna (KtK)

SIDA ka dhënë mbështetje për organizatat e grave në Kosovë përmes KtK (http://kvinnatillkvinna.se/en/). Kjo mbështetje do të vazhdojë

deri në vitin 2014, duke përfshirë edhe ndihmën për Fondin e Grave të RrGGK-së, fond ky që do të ofroj mbështetje edhe për një raund të granteve për organizatat e grave në vitin 2014 (varësisht nga aprovimi). KtK do të pushoj së funksionuari në Kosovë në vitin 2015. Sida planifikon të vazhdoj mbështetjen për grupet e grave edhe pas vitit 2015. Janë në proces të zhvillimit të strategjisë, që do të identifikoj se kujt do të i ofrohet kjo mbështetje.

Swiss International Cooperation (SDC)

The Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) ka një linjë për grantë të vogla përmes së cilës mbështet organizatat e SHC me shumë prej €12,000, me kohëzgjatje deri në 12 muaj. Projektet duhet të ndihojnë grupet e margjinalizuara. Më shumë informacione mund të gjeni në: http://www.swiss-cooperation.admin.ch/kosovo/en/Home/Small_Actions_Credit_Line.

UN Women

UN Women ofron mundësi për organizatat e grave, varësisht nga fondet që kanë në dispozicion.

Urgent Action Fund (UAF)

UAF punon në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grave përmes grantit që shërben si grant emergjent, hulumtim, publikim dhe evokim dhe ndërtim të aleancave. Organizatat e grave në Kosovë mund të aplikojnë në zyrat e tyre ne SHBA. Për më shumë informacione vizitoni: www.urgentactionfund.org.

U.S. Embassy

Ambasada Amerikane në Kosovë ka Komisionin për Grante të Vogla që është e hapur për SHC. Informacionet mund të i gjeni në: http://www.womensnetwork.org/?FaqeID=33.

Shtojca 3. Metodologjia e hulumtimit

Hulumtimi është zhvilluar duke përdor këto metoda dhe analiza:

Pyetësor me Organizatat e Grave: RrGGK-ja dhe AH kanë intervistuar 90 organizata të grave në Kosovë, nga 103 ekzistuese. Këto intervista janë zhvilluar përmes takimeve me organizatat, dhe kjo ka ndihmuar të takojnë dhe të marrim informacione nga grupe të cilat nuk do të kishin mundësi të plotësojnë pyëtësorin online. Kjo gjithashtu ishte mundësi e mirë për verifikim dhe për sigurim që të dhënat janë sa më të sakta dhe të plota. Pyetësori dhe të dhënat janë futur në SPSS dhe Excel, janë pastruar dhe janë analizuar nga ekipi hulumtues. Të dhënat kualitative janë koduar.

Intervista me donatorët: Janë intervistuar dhe/apo janë kontaktuar me email 40 donatorë në Kosovë. Ekipa gjithashtu ka intervistuar disa nga institucionet kyqe qeveritare në mënyrë që të marrin informacione shtesë rreth mbështejtjes financiare të organizatave të grave. Informacionet janë koduar, dhe janë analizuar duke nxjerr kështu informacionet kyqe nga intervistat e zhvilluara.

Hulumtim plotësues: Ekipi hulumtues ka analizuar raportet e auditivit, raportet vjetore dhe raporte tjera të cilat janë gjetur online, raporte të donatorëve, website, dhe informata tjera në gazeta, burime nga qeveria, apo libra dhe revista akademike.

Limitet/Dobësitë: Limitet më të mësdha në këtë hulumtim ishte koha e shkurtër për zhvillimin e hulumtimit. Refuzimet për pjesëmarrje nga disa donatorë dhe nga disa organizata, shpesh me arsyetimin e "konfidencialitetit", si dhe vështirësit për të vënë kontakt me donatorët të cilët nuk janë më në Kosovë, ka ndikuar që ky hulumtim të ketë "zbrastësi" në prezantimin e të dhënave, dhe kështu duke mos mundur të prezantojmë në tërësi financimin e përgjithshëm për këtë sektor. Në disa raste të dhënat që kemi marr nga donatorët dhe të dhënat e ofruara nga OJQ-te nuk korrespondonin. Ekipi hulumtues provoi të zgjidh këto duke hulumtuar tutje. Mirëpo, me gjithë

dobësitë apo limitet që ky hulumtim ka, sjell rekomandime dhe të gjetura të reja në këtë fushë.

Vlefshmëria: Ekipi hulumtues ka përdorë metodën e validitetit apo vlefshmërisë së të dhënave përmes metodave të ndryshme, konsultimin e burimit të të dhënave, dhe hulumtuesve, duke pasqyruar kështu në mënyrë holistike gjendjen, në bazë të përgjigjeve të dhëna në pyetësor. Verifikimi me pjesëmarrës në hulumtim ishte edhe një hap tjetër për verifikimin e vlefshmërisë së të dhënave.

Shtojca 4. Organizatat e anketuara

Ekipi hulumtues ka anketuar 90 nga 103 organizata të grave të cilat dihet se ekzistojnë në Kosovë në kohën e këtij hulumtimi. Në mesin e të anketuarve, organizata më e vjetër ishte themeluar në vitin 1994 ndërsa më e re në vitin 2013 (shih Grafikun 16). Zona me ngjyrë të mbyllur tregon numrin e organizatave të reja që themelohen çdo vit, ku më së shumti ishin krijuar në vitin 2000 (13 OSHC).

Grafiku 16. Numri i organizatave të themeluar sipas viteve



Mostra përfshin OSHC-të nga lokacione të ndryshme gjeografike, që përfaqësojnë popullatën e organizatave të grave në Kosovë (shih Grafikun 17): prej tyre 83% ishin urbane dhe 17% rurale. Për nga fokusi gjeografik, 36% thanë se janë të fokusuar në punën e tyre kryesisht në nivelin lokal, 62% në nivel kombëtar, ndërsa 2% në atë ndërkombëtar. Disa sosh kanë punuar në nivele të ndryshme.

Grafiku 17. Lokacionet e organizatave



Lloji i organizatës dhe fokusi

Shumica e të anketuarve e konsiderojnë veten si organizatë për fuqizim të grave (70%).[61] Ashtu siç tregon Grafiku 18, më pak organizata fokusohen në të drejta të grave rights (27%) dhe/ose barazi gjinore (22%). Vetëm katër përqind identifikohen si feministe. Më shumë se një e katërta merren me një varg çështjesh të cilat jo domosdoshmërisht ndërlidhen me të drejta të grave, barazi gjinore, dhe/ose fuqizim.

Grafiku 18. Lloji i organizatave të anketuara



Shumica e organizatave punojnë me të gjitha grupet etnike në Kosovë (shih Grafikun 19). Në total, të anketuarit pohojnë se kanë 15,028 anëtarë, me mesatarisht169 anëtarë për organizatë.

Grafiku 19. Numri i OSHC-ve që punjnë me grupe etnike



[61] Të anketuarit mund të përzgjidhnin të gjitha kategoritë relevante për organizatën e tyre. Prandaj, përqindjet nuk pasqyrojnë shumën prej 100% pasi që disa organizata identifikuan disa lëmi.

Shtojca 5. Lista e Organizatave që morën pjesë në hulumtim

1. Alma
2. Alter Habitus
3. Artpolis
4. Asociacioni i Grave të Mitrovicës
5. Centar za Ekonomski Razvoj Zena u Sterpci
6. Dera e Hapur
7. Diakonie Kosova
8. Dora e Ngrohtë
9. Down Syndrome Kosova
10. Duart e Dardanës
11. Emina Grupi i Grave Boshnjake
12. Familja dhe Shpresa
13. Fatjona
14. Femra për Femra me Aftësi të Kufizuara
15. Femrat Aktive të Gjakovës
16. Femra Vizionare e Shekullit XXI
17. Foleja
18. Fondacioni për Edukim dhe Zhvillim
19. Fortesa
20. Forumi Demokratik i Gruas
21. Gruaja Bashëkohore
22. Gruaja Hyjnore
23. HANDIKOS Femrat me Aftësi të Kufizuara
24. Hanemeli
25. Hendifer
26. Indira
27. Iniciativa 6
28. Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës
29. Jeta/Vita
30. Jeta Ime
31. Kelmendi
32. Klubi i Basketit me Karroca Marsi
33. Komiteti i Grave Të Verbëra
34. Kori i Grave Lira
35. Krusha e Vogël
36. Legjenda
37. Lepsa Buducnost
38. Lidhja e Invalidëve, Viktimave Civile dhe Femrat e Dhunuara Drenas

39. Lidhja e Invalidëve, Viktimave Civile dhe Femrat e Dhunuara Fushë Kosovë
40. Lulebora
41. Lulishtja
42. Luna
43. Medika BL
44. Medika Gjakova
45. Medika Kosova
46. Mundësia
47. Nderi
48. Ne Jemi Pjesë e Botës
49. OJQ Arta
50. OJQ Bliri
51. OJQ Diana
52. OJQ Fana
53. OJQ Kalabria
54. Okarina e Runikut
55. One to One Kosova
56. Organizata për Persona me Distrofi Muskulare
57. Parajsa Jonë
58. Prehja
59. Qendra e Gruas Ato
60. Qendra MVPT
61. Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
62. Qendra Kosovare për Studime Gjinore
63. Qendra për Ardhmëri të Sigurtë
64. Qendra Për Këshillim dhe Përkrahje të Femrës
65. Qendra për Mirëqenien e Gruas dhe Fëmijës
66. Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave
67. Qendra për Strehimin e Grave dhe Femrave
68. Qendra për Trajnime dhe Studime Gjinore
69. Rikotta
70. Rona
71. Rrjeti i Organizatave të Grave RAE të Kosovës
72. Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
73. Ruka Ruci
74. Shoqata e Grave Drita e Krushës
75. Shoqata e Grave Gora
76. Shoqata e Juristeve Norma
77. Shoqata Afariste e Gruas
78. Shoqata e Grave Begatia
79. Shoqata e të Shurdhërve Prizren

80. Shoqata Iniciativa e Grave
81. Shoqata Ndërkombëtare e të Verbërve
82. Shoqata për Edukim dhe Përkujdesjen e Familjes
83. Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijve
84. Shtëpia e Sigurtë
85. Top Radio
86. Venera
87. Violete
88. Vita-Jeta
89. Women for Women
90. Zana

Organizata e gruas Aureola ka dërguar të dhënat financiare mirëpo, pyetësori për këtë organizatë nuk është plotësuar.

Shtojca 6. Lista e Donatorëve që janë konsultuar

1. Amica
2. Austrian Development Agency
3. British Embassy
4. Caritas Kosova
5. Cfd The Feminist Peace Organisation
6. Danish Refugee Council
7. East West Managment Institute
8. Embassy of Austria
9. Embassy of Finland
10. Embassy of France
11. Embassy of Norway
12. Embassy of the Kingdom of the Netherlands
13. Embassy of Switzerland
14. European Union Office in Kosovo
15. Global Fund for Women
16. Helvetas Swiss Inter-cooperation
17. International Organization for Migration
18. Kosovo Civil Society Foundation
19. Kosovo Foundation for Open Society
20. Kvinna till Kvinna
21. Ministry of Labour and Social Welfare (MLSW)
22. Olaf Palme
23. Organization for Security and Co-operation in Europe
24. Rockefeller Brothers Fund
25. Swiss Cooperation Office
26. Swedish International Development Agency
27. Soros Foundations (previously Open Society Institute)
28. U.S. Department of Justice Overseas Prosecutorial Development, Assistance and Training
29. UN Women
30. United Nations Children's Fund (UNICEF)
31. United Nations Development Program
32. United Nations Food and Agriculture Organization (FAO)
33. United Nations High Commissioner for Refugees (UNHCR)
34. United Nations Kosovo Team Gender-Based Violence Programme
35. United Nations Population Fund (UNFPA)
36. United States Agency for International Development (USAID)
37. United States Embassy
38. Weltegebetstag (WGT)
39. World Bank

40. World Vision

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

305-055.2(496.51)

Ku janë paratë për të drejtat e grave? : Rast studimi për Kosovën / Nga Nicole Farnsworth dhe Elmaze Gashi. - Prishtinë : Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2013. - 102 f. : ilustr. me ngjyra ; 21 cm.
1. Farnsworth, Nicole 2. Gashi, Elmaze

ISBN 978-9951-8848-2-2

ISBN 978-9951-8848-2-2

Printim ekologjik.